<p>2.3.Nuk iu janë bashkangjitur me kohë provat.</p> <p>2.4. Kërkesa dhe faktet e siguruara nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 20 të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 Ankesa</p> <p>1. Kundër aktvendimit të shkallës së parë, personi i dënuar mund t'i parashtrojë ankesë kryetarit të Gjykatës së Apelit brenda tri (3) ditëve nga pranimi i aktvendimit.</p> <p>2. Kryetari i Gjykatës së Apelit vendosë për ankesën brenda tri (3) ditëve nga pranimi i saj.</p>	<p>2.3. the evidence was not attached in time.</p> <p>2.4. the request and the provided facts do not meet the requirements prescribed in article 20 of this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 Appeal</p> <p>1. The convicted person may file an appeal against the ruling of first instance to the President of the Court of Appeals within three (3) days from the receipt of the ruling.</p> <p>2. The President of the Court of Appeals shall rule on the appeal within three (3) days from its receipt.</p>	<p>2.3. ako uz zahtev nisu blagovremeno priloženi dokazi.</p> <p>2.4. zahtev i priložene činjenice ne ispunjavaju uslove propisane u članu 20 ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Žalba</p> <p>1.Osudeno lice može da uloži žalbu na prvostepeno rešenje predsedniku Apelacionog suda u roku od tri (3) dana od prijema rešenja.</p> <p>2.Predsednik Apelacionog suda odlučuje o žalbi u roku od tri (3) dana od prijema žalbe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 25 Pezullimi i ekzekutimit të dënimit për shkak të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit</p> <p>1. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit nuk e pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim, derisa të merret vendim i formës së prerë lidhur me kërkesën.</p>	<p style="text-align: center;">Article 25 Suspension of the execution of imprisonment due to the request for postponement of the execution</p> <p>1. The request for the postponement of the execution of imprisonment shall not suspend the execution of imprisonment, until a final decision is rendered in relation to the request.</p>	<p style="text-align: center;">Član 25 Obustavljanje izvršenja kazne zbog molbe za odlaganje</p> <p>1.Zahtev za odlaganje izvršenja ne zadržava izvršenje kazne do pravosnažnosti odluke kojom je odlučeno po zahtevu.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 26</p> <p style="text-align: center;">Raporti për gjendjen shëndetësore për shkak të sëmundjes së rëndë</p> <p>Personi i dënuar, të cilit i është shtyrë ekzekutimi i dënimit për shkak të sëmundjes së rëndë, duhet të dorëzojë raport për gjendjen e tij shëndetësore të lëshuar nga institucioni mjekësor ku është duke u trajtuar një herë në tre (3) muaj, ose me kërkesë të gjykatës kompetente, edhe më shpesh, përveç nëse parashihet ndryshe me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.</p>	<p style="text-align: center;">Article 26</p> <p style="text-align: center;">Report on the health condition due to serious illness</p> <p>Convicted person, whose execution of imprisonment was postponed due to serious illness, shall submit a report on his health condition issued by the medical institution where he is treated, every three (3) months, or upon the request of the competent court, even more frequently, unless otherwise provided by the respective provisions of the Criminal Procedure Code.</p>	<p style="text-align: center;">Član 26</p> <p style="text-align: center;">Izveštaj o zdravstvenom stanju zbog teške bolesti</p> <p>Osuđeno lice kojem je odloženo izvršenje kazne zbog ozbiljne bolesti mora da dostavlja izveštaj o svom zdravstvenom stanju od medicinske institucije u kojoj se nalazi na lečenju jednom u tri (3) meseca, a na zahtev nadležnog suda i češće, osim ako se drugačije ne predviđaju odredbe Zakona o krivičnom postupku.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 27</p> <p style="text-align: center;">Revokimi dhe ndërprerja e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim</p> <p>1. Kryetari i gjykatës themelore kompetente, e revokon shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim, nëse ndërkohë konstatohet se arsyet për lejimin e shtyrjes nuk kanë ekzistuar ose kanë pushuar së ekzistuari, ose personi i dënuar e ka shfrytëzuar periudhën e shtyrjes për qëllime të tjera, e jo për ato për të cilat është lejuar shtyrja.</p> <p>2. Nëse shtyrja i është lejuar gruas shtatzënë, fëmija i së cilës nuk ka lindur i gjallë, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas lindjes, dhe</p>	<p style="text-align: center;">Article 27</p> <p style="text-align: center;">Revocation and termination of the postponement of the execution of imprisonment</p> <p>1. The President of the competent Basic Court shall revoke the postponement of the execution of imprisonment, if in the meantime it is established that the reasons for granting the postponement did not exist, or ceased to exist, or the convicted person used the period of postponement for other purposes other than those for which the postponement was granted.</p> <p>2. If the postponement is granted to a pregnant woman, who had a stillbirth, the postponement shall be terminated six (6)</p>	<p style="text-align: center;">Član 27</p> <p style="text-align: center;">Opoziv i prekid odlaganja izvršenja kazne zatvora</p> <p>1. Predsednik nadležnog osnovnog suda opozvaće odlaganje izvršenja kazne zatvora ako se naknadno ustanovi da razlozi za odobrenje odlaganja nisu postojali ili su prestali da postoje, ili da je osuđeno lice iskoristilo period odlaganja u neku drugu svrhu a ne onu zbog koje mu je odobreno odlaganje.</p> <p>2. Ako je odlaganje odobreno trudnici koja potom rodi mrtvo dete, odlaganje se prekida šest</p>

<p>nëse fëmija vdes pas lindjes, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas vdekjes së fëmijës.</p> <p>3. Nëse shtyrja i është lejuar nënës së fëmijës më të ri se një (1) vit, i cili vdes, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas vdekjes së fëmijës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Ankesa kundër aktvendimit për revokimin, ose ndërprerjen e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim</p> <p>1. Personi i dënuar me burgim ka të drejtë ankese kundër aktvendimit për revokimin ose ndërprerjen e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim nën kushte të njëjta, si edhe kundër aktvendimit në bazë të të cilit është vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje.</p> <p>2. Ankesa e shtynë ekzekutimin e aktvendimit.</p>	<p>months after the birth, and if the child passes away after the birth, the postponement shall be terminated six (6) months after the death of the child.</p> <p>3. If the postponement is granted to the mother of a child who passed away when younger than one (1) year of age, the postponement shall be terminated six (6) months after the death of the child.</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Appeal against the ruling on revocation or termination of the postponement of the execution for imprisonment</p> <p>1. A person punished by imprisonment has the right to appeal the ruling on revocation or termination of the postponement of the execution of imprisonment under the same conditions as for the ruling on the request for postponement.</p> <p>2. The appeal shall postpone the execution of the ruling.</p>	<p>(6) meseci posle porođaja, a ako dete umre posle porođaja, odlaganje se prekida šest (6) meseci od smrti deteta.</p> <p>3. Ako je odlaganje odobreno majci deteta mlađeg od godinu dana koje potom umre, odlaganje se prekida šest (6) meseci od smrti deteta.</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Žalba protiv rešenja za opozivanje (revokaciju), odnosno prestanak odlaganja izvršenja kazne zatvora</p> <p>1. Osuđeno lice ima pravo žalbe na rešenje o opozivu ili prekid odlaganja izvršenja kazne zatvora pod istim uslovima kao i za žalbu na rešenje kojim je odlučeno o zahtevu za odlaganje.</p> <p>2. Žalba odlaže izvršenje rešenja.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 29 Shtyrja e ekzekutimit lidhur me mjetet e jashtëzakonshme juridike</p> <p>1. Gjykata që vendosë lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës penale të parashtruar në favor të personit të dënuar, mund ta shtyjë ekzekutimin e dënimit me burgim, edhe para hyrjes në fuqi të aktvendimit me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale.</p> <p>2. Gjykata që vendosë lidhur me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund ta shtyjë ekzekutimin e dënimit, varësisht nga përmbajtja e kërkesës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 29 Postponement of execution through extraordinary legal remedies</p> <p>1. The court that rules on the request for the repeat of criminal proceedings that were in the favor of the convicted person, may postpone the execution of imprisonment, even before the entry into force of the ruling granting the repeat of the criminal proceedings.</p> <p>2. The court that rules on the request for extraordinary lenient punishment, may postpone the execution of imprisonment, depending on the content of the request.</p>	<p style="text-align: center;">Član 29 Odlaganje izvršenja kod primene vanrednih pravnih lekova</p> <p>1. Sud koji odlučuje o zahtevu za ponavljanje krivičnog postupka podnetog u korist osuđenog lica može da odloži izvršenje kazne zatvora, čak i pre nego što rešenje kojim se dozvoljava ponavljanje krivičnog postupka stupi na snagu.</p> <p>2. Sud koji odlučuje o zahtevu za vanredno ublažavanje kazne može da odloži izvršenje kazne zatvora u zavisnosti od sadržine zahteva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 30 Lejimi i shtyrjes së ekzekutimit të dënimit me burgim me kërkesë të Prokurorit të Shtetit</p> <p>1. Me kërkesë të Prokurorit kompetent të Shtetit, lejohet shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim, derisa të merret vendimi për shfrytëzimin e mjetit juridik.</p> <p>2. Vendimi për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim pushon të vlej, nëse prokurori i shtetit nuk e shfrytëzon mjetin juridik brenda tridhjetë (30) ditëve nga</p>	<p style="text-align: center;">Article 30 Granting of postponement of the execution of imprisonment upon the request of State Prosecutor</p> <p>1. Upon the request of the competent State prosecutor the postponement of the execution of imprisonment is granted until a decision on the use of legal remedy is rendered.</p> <p>2. The decision on the postponement of the execution of imprisonment shall be void if the state prosecutor does not use the legal remedy within thirty (30) days from the receipt of</p>	<p style="text-align: center;">Član 30 Odobrenje za odlaganje izvršenja kazne zatvora na zahtev državnog tužioca</p> <p>1. Na zahtev nadležnog državnog tužioca uvek se odobrava odlaganje izvršenja kazne zatvora do donošenja odluke o pravnom leku.</p> <p>2. Odluka o odlaganju izvršenja kazne zatvora prestaje da važi ako državni tužilac ne iskoristi pravni lek u roku od trideset (30) dana od prijema odluke o odlaganju izvršenja.</p>

<p>pranimi i vendimit për shtyrjen e ekzekutimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 31 Pranimi i personit të dënuar në institucionin korrektues</p> <p>1.Kur personi i dënuar pranohet në institucionin korrektues, së pari vërtetohet identiteti i tij, baza dhe urdhëresa për ekzekutimin e dënimit me burgimin, ose burgimin e tij të përjetshëm dhe të njëjtit i hapet dosja personale me të dhënat përkatëse.</p> <p>2.Shërbimi përkatës shëndetësor brenda afatit prej njëzetekatër (24) orëve nga pranimi, i hapë dosjen mjekësore, qasja dhe trajtimi së cilës bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>3.Personave të dënuar me rastin e pranimi të tyre në institucion korrektues u lejohen gjësendet e caktuara në qelitë e tyre. Çdo gjësend, i cili nuk lejohet në qelitë e tyre ose do të ruhet në depo të sigurta nga Shërbimi Korrektues deri në lirimin e personit të dënuar, ose mund t'i jepet një personi të tretë me kërkesën e të dënuarit.</p> <p>4.Me rastin e pranimi në institucionin korrektues, personi i dënuar njoftohet me</p>	<p>decision on the postponement of the execution.</p> <p style="text-align: center;">Article 31 Admission of convicted person to correctional institution</p> <p>1. When a convicted person is admitted to a correctional institution, his identity, grounds, order for the execution of imprisonment, or life imprisonment are confirmed first and then his personal file with corresponding records is opened.</p> <p>2. The respective health service within a period of twenty four (24) hours from the admission, shall open the medical file, the access and treatment of which is governed by the corresponding provisions of the applicable law on the protection of personal data.</p> <p>3. Upon their admission to the correctional institution, the convicted persons are allowed to have certain items in their cells. Any item which is not allowed in their cells shall be kept in a safe storage by the Correctional Service until the release of the convicted person, or shall be given to a third person upon the request of the convicted person.</p> <p>4. Upon his admission to the correctional institution, the convicted person is notified in</p>	<p style="text-align: center;">Član 31 Prijem osuđenog lica u kazneno popravnu ustanovu</p> <p>1.Kada se osuđeno lice prima u Kazneno popravnu ustanovu, prvo se utvrđuje njegov identitet, osnova i ovlašćenje za njegovu kaznu zatvora ili doživotnog zatvora, a zatim se otvara njegov lični dosije sa odgovarajućim podacima.</p> <p>2. Odgovarajuća zdravstvena služba u roku od dvadeset četiri (24) sata od prijema, otvara lekarski dosije, čiji pristup i tretman regulišu odgovarajuće odredbe važećeg zakona o zaštiti ličnih podataka.</p> <p>3. Po prijemu u Kazneno popravnu ustanovu, osuđenim licima je dozvoljeno da imaju određene predmete u svojim ćelijama. Bilo koji predmet koji nije dopušten u njihovim ćelijama čuvaće se od strane Kazneno popravne ustanove sve do puštanja osuđenog lica, ili će mu se na zahtev osuđenog dati trećem licu.</p> <p>4. Po prijemu u Kazneno popravnu ustanovu, osuđeno lice se pismenim putem obaveštava</p>
---	---	--

<p>shkrim për të drejtat dhe detyrimet që i ka gjatë mbajtjes së dënimit. Personi i dënuar i cili nuk dinë shkrim dhe lexim njoftohet gojarisht.</p> <p>5. Teksti i këtij ligji dhe aktet nënligjor në institucionet korrektuese janë në dispozicion në gjuhën të cilën e kupton personi i dënuari gjatë tërë kohës së mbajtjes së dënimit, në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare.</p> <p>6. Procedurat në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen në prani të personave të tjerë të dënuar. Personi i dënuar fotografohet.</p>	<p>writing about his rights and obligations during the imprisonment. The convicted person who is illiterate shall be notified verbally.</p> <p>5. In accordance with the law on the use of official languages, throughout the time of imprisonment, the text of this law and the bylaws shall be available in the correctional institutions in the language that the convicted person understands.</p> <p>6. The procedures under paragraph 1 and 2 of this article are conducted in the presence of the convicted persons. A photograph of the convicted person shall be taken.</p>	<p>o njegovim pravima i obavezama tokom održavanja kazne. Osuđeno lice koji je nepismeno, će biti verbalno obavješten.</p> <p>5. U skladu sa zakonom o upotrebi službenih jezika, u toku trajanja održavanja kazne, tekst ovog zakona i podzakonskih akata bit će dostupni u Kazneno popravnim ustanovima na jeziku koji osuđeno lice razume.</p> <p>6. Postupci iz stava 1. i 2. ovog člana sprovode se u prisustvu osuđenih lica. Osuđeno lice će biti fotografisano.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 32 Rendi shtëpiak</p> <p>1. Me aktin nënligjor për rendin shtëpiak në institucionet korrektuese (më tej: akti për rendin shtëpiak), të cilin e nxjerrë Ministri, rregullohet organizimi dhe mënyra e jetës së personave të dënuar dhe të personave të paraburgosur, e në veçanti:</p> <p>1.1. Pranimi dhe vendosja;</p> <p>1.2. Njohja me rendin shtëpiak dhe me dispozitat e tjera;</p>	<p style="text-align: center;">Article 32 House rules</p> <p>1. The bylaw on the house rules in the correctional institutions (hereinafter: act on house rules), which is adopted by the Minister, shall govern the organization and the way of living of convicted person and detainees, in particular:</p> <p>1.1. admission and placement;</p> <p>1.2. introduction to the house rules and other provisions;</p>	<p style="text-align: center;">Član 32 Kućni red</p> <p>1. Podzakonskim aktom o kućnom redu kazneno popravne ustanove (u daljem tekstu: akt o kućnom redu), koji donosi ministar, uređuju se organizacija i način života osuđenih lica i pritvorenih lica, a naročito:</p> <p>1.1. prijem i smeštaj;</p> <p>1.2. upoznavanje sa kućnim redom i drugim pravilima;</p>

<p>1.3.Ushqimi, mbrojtja shëndetësore dhe zbatimi i masave higjienike;</p> <p>1.4.Mënyra e plotësimit të nevojave fetare;</p> <p>1.5.Korrespondenca, pranimi i vizitave dhe i paketave;</p> <p>1.6.Llojet dhe sasi të prodhimeve ushqimore të cilat mund të pranohen përmes kantinës;</p> <p>1.7.Kushtet dhe mënyra e disponimit me të hollat e fituara si kompensim për punë dhe shpërblimet;</p> <p>1.8.Mënyra e shfrytëzimit të pushimit vjetor;</p> <p>1.9.Mbajtja e rendit dhe disiplinës;</p> <p>1.10.Sistemi i shkeljeve disiplinore dhe të sanksioneve;</p> <p>1.11.Kushtet dhe mënyra e aplikimit të masave disiplinore, masave të vetmisë;</p> <p>1.12.Llojet e beneficioneve, të kushteve dhe mënyrës së</p>	<p>1.3. food, healthcare, and implementation of hygienic measures;</p> <p>1.4. manner of fulfilling religious needs;</p> <p>1.5. correspondence, receipt of visits and parcels;</p> <p>1.6. types and quantity of food products that can be received through canteen;</p> <p>1.7. conditions and manner of utilizing the money earned as compensation for work and remunerations;</p> <p>1.8. manner of using the annual leave;</p> <p>1.9. maintaining order and discipline;</p> <p>1.10. system of disciplinary violations and sanctions;</p> <p>1.11. conditions and manner of applying the disciplinary measures, and measures of solitary confinement;</p> <p>1.12. types of benefits, conditions and manner of using all benefits;</p>	<p>1.3. Ishrana, zdravstvena zaštita i sprovođenje mera higijene;</p> <p>1.4. Način zadovoljenja verskih potreba;</p> <p>1.5. Prepiska, prijem poseta i paketa;</p> <p>1.6. Vrsta i količina prehrambenih proizvoda koje sme da primi;</p> <p>1.7. Uslovi i način raspolaganja novcem dobijenim kao naknadu za rad i nagradu;</p> <p>1.8. Način korišćenja godišnjeg odmora;</p> <p>1.9. Održavanje reda i discipline;</p> <p>1.10. Sistem disciplinskih prekršaja i sankcija;</p> <p>1.11. Uslovi i način primene disciplinskih mera, mera samice;</p> <p>1.12. Vrste privilegija, uslovi i način za korišćenje svih privilegija;</p>
---	--	--

<p>shfrytëzimit të të gjitha beneficioneve;</p> <p>1.13.Organizimi i aktiviteteve kulturore, arsimore, sportive dhe argëtuese;</p> <p>1.14.Qëndrimi në hapësirë të hapur;</p> <p>1.15.Lirimi dhe ndihma me rastin e lirit nga mbajtja e dënimit me burg apo nga paraburgimi;</p> <p>1.16. Gjësendet që lejohen;</p> <p>1.17.Çështjet e tjera të cilat janë me rëndësi për kushtet dhe mënyrën e mbajtjes së masës së dënimit me burgim dhe paraburgim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 33 Vendosja e personave të dënuar në institucionin korrektues</p> <p>1.Institucioni korrektues i mundëson personit të dënuar kontakt të menjëhershëm me anëtarët e familjes pas pranimit të tij. Shtetasit të huaj i ofrohet mundësia që me shkrim, ose me telefon ta kontaktojë përfaqësuesin diplomatik, apo zyrën</p>	<p>1.13. organizing cultural, educational, sport and entertainment activities;</p> <p>1.14. staying in open air;</p> <p>1.15. release and assistance upon release from imprisonment or life imprisonment;</p> <p>1.16. items allowed;</p> <p>1.17. other matters that are important for the conditions and manner of serving the imprisonment and detention.</p> <p style="text-align: center;">Article 33 Placement of convicted person in correctional institution</p> <p>1. Correctional institution shall enable the convicted person immediate contact with his family members after his admission. The foreign citizens shall be enabled to contact in writing or by phone the diplomatic representative, or the respective office of the state of his citizenship.</p>	<p>1.13. Organizovanje kulturnih, nastavnih, sportskih i zabavnih aktivnosti;</p> <p>1.14. Boravak na otvorenom prostoru;</p> <p>1.15. Puštanje iz zatvora i pomoć prilikom oslobađanja od izdržavanja kazne zatvora ili pritvora;</p> <p>1.16. Dozvoljene stvari</p> <p>1.17. Druga pitanja koja su od značaja za način izdržavanja kazne zatvora i mere pritvora.</p> <p style="text-align: center;">Član 33 Raspoređivanje osuđenog lica u kazneno popravnu ustanovu</p> <p>1.Kazneno popravna ustanova omogućava osuđenom licu da odmah posle prijema stupi u kontakt sa članovima porodice. Stranom državljaninu pruža se mogućnost da pisanim putem ili telefonom stupi u kontakt sa diplomatskim predstavnikom ili nadležnom kancelarijom države čije državljanstvo ima.</p>
---	---	---

<p>përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai.</p> <p>2.Nëse personi i dënuar ka fëmijë të mitur ose persona për të cilët ka përgjegjësi të veçantë për përkujdesje, institucioni korrektues lidhur me këtë rrethanë e informon organin e kujdestarisë.</p> <p>3.Gjatë vendosjes së personit të dënuar në institucionin e veçantë korrektues ose në njësi të veçantë të institucionit korrektues, duhet të merret parasysh mosha e tij, llojet dhe pesha e dënimit, fakti se a ka qenë me parë i dënuar, shëndeti i tij fizik dhe mendor, kërkesat për trajtim të veçantë, lokacioni i vendbanimit, ose i vendqëndrimit të familjes së tij, siguria e tij, si dhe arsyet lidhur me arsimimin, ose punët që mund të jenë të rëndësishme për riintegrimin e tij shoqëror.</p> <p>4.Me rastin e vendosjes së personit të dënuar, po ashtu duhet të merret parasysh mundësia për zbatimin e programeve të përbashkëta risocializuese, si dhe nevoja për shmangien e ndikimeve negative.</p> <p>5.Personat e dënuar meshkuj dhe femra vendosen ndarazi. Gratë shtatzëna, gratë që lindin fëmijë dhe nënat që përkujdesen për fëmijët e tyre vendosen ndarazi nga gratë e tjera të dënuara.</p>	<p>2. If the convicted person has underage children or persons that he has special caring responsibility, the correctional institution shall inform the guardianship authority about such circumstance.</p> <p>3. When placing the convicted person in a special correctional institution, or special unit of correctional institution, his age, type and seriousness of punishment, his physical and mental health, needs for special treatment, location of permanent or current residence of his family, his security, reasons related to education, or affairs that may important for his social reintegration shall be taken into consideration.</p> <p>4. During the placement of the convicted person, the possibility of implementing joint resocialization programs and the need for avoiding negative impacts shall also be taken into consideration.</p> <p>5. The male and female convicted persons shall be placed separately. Pregnant women, women giving birth and mother caring for their children shall be placed separately from other convicted women.</p>	<p>2.Ako osuđeno lice ima maloletnu decu ili osobe za čije je staranje isključivo odgovorno, kazнено popravna ustanova o tome obaveštava organ starateljstva.</p> <p>3.Prilikom raspoređivanja osuđenog lica u određenu kazнено popravnu ustanovu ili u neku posebnu jedinicu kazнено popravne ustanove treba imati u vidu njegovu starost, vrstu i težinu kazne, činjenicu o ranijem kažnjavanju, njegovo fizičko i mentalno zdravlje, zahtev za posebni tretman, mesto prebivališta ili boravišta njegove porodice, njegovu bezbednost, kao i razloge vezane za obrazovanje ili posao koji mogu biti od značaja za njegovu reintegraciju u društvo.</p> <p>4.Prilikom raspoređivanja osuđenog lica takođe treba voditi računa o mogućnosti za sprovođenje zajedničkih programa resocijalizacije i potrebi da se izbegnu negativni uticaji.</p> <p>5.Osuđena lica muškog i ženskog pola smeštaju se odvojeno. Trudnice, žene pred porođajem i majke koje se staraju o svojoj deci moraju da budu smeštene odvojeno od ostalih žena na izdržavanju kazne.</p>
--	--	---

<p>6. Personat madhorë nuk vendosen në institucionin korrektues ose në një pjesë të institucionit korrektues me të miturit.</p> <p>7. Personat e dënuar nuk vendosen në të njëjtën pjesë të institucionit me personat e paraburgosur.</p> <p>8. Duhet bërë përpjekje të mëdha që personat e dënuar për herë të parë të ndahen nga personat të cilët më parë kanë mbajtur dënimin me burgim.</p>	<p>6. Adult persons shall not be placed in the correctional institution or in any part of the correctional institution together with the minors.</p> <p>7. The convicted person shall not be placed in the same place of the institution together with the detainees.</p> <p>8. Great effort shall be made to separate the convicted persons for the first time from persons who served imprisonment before.</p>	<p>6. Punoletna lica se ne smeštaju zajedno sa maloletnim licima u kazneno popravnoj instituciji ili u nekom delu kazneno popravne institucije.</p> <p>7. Osuđena lica ne mogu da budu smeštena u isti deo ustanove sa osobama kojima je određen pritvor.</p> <p>8. Treba uložiti najveće napore da osobe osuđene prvi put budu odvojene od osoba koje su već bile na izdržavanju kazne zatvora.</p>
<p>Neni 34 Ndarja nga personat e dënuar</p>	<p>Article 34 Separation from convicted person</p>	<p>Član 34 Odvajanje osuđenih lica</p>
<p>1. Me kërkesë të personit të dënuar, drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë që personi i dënuar të ndahet nga personat e tjerë të dënuar në një njësi të veçantë të institucionit korrektues, nëse drejtori konstaton se arsyet e paraqitura në kërkesën e personit të dënuar janë të arsyeshme dhe nuk ka mundësi të tjera për zgjidhjen e tyre.</p> <p>2. Drejtori i institucionit korrektues mund të urdhërojë që personi i dënuar të ndahet nga personat e tjerë të dënuar edhe pa kërkesën e personit të dënuar vetëm kur kjo masë është e nevojshme:</p>	<p>1. Upon the request of a convicted person, the director of correctional institution may permit that the convicted person is separated from other convicted persons in a special unit of the correctional institution, if the director establishes that the reasons provided in the request of the convicted person are justifiable and there is no other way to settle them.</p> <p>2. Director of correctional institution may order that a convicted person is separated from other convicted persons even without the request of the convicted person only when this measure is necessary:</p>	<p>1. Na molbu osuđenog lica direktor kazneno popravne ustanove može da dozvoli osuđenom licu da bude odvojeno od drugih osuđenih lica u nekoj posebnoj jedinici kazneno popravne ustanove, ako utvrdi da su razlozi navedeni u zahtevu osuđenog lica opravdani i da ne postoje druge mogućnosti za njihovo rešavanje.</p> <p>2. Direktor kazneno popravne ustanove može da naloži da se osuđeno lice odvoji od drugih osuđenih i bez molbe osuđenog lica za odvajanjem, samo ako je ta mera neophodna:</p>

<p>2.1.Për t'iu shmangur rrezikut për jetën ose shëndetin e personit të dënuar, ose të personave të tjerë;</p> <p>2.2.Për t'iu shmangur rrezikut të sigurisë në institucionin korrektues të shkaktuar nga prania e vazhdueshme e personit të dënuar në mesin e të burgosurve dhe personave të tjerë të burgut, ose</p> <p>2.3.Për të siguruar integritetin e hetimit të ndonjë çështjeje disiplinore.</p> <p>3. Vendimi nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni merret pas hetimit të të gjitha rrethanave relevante. Ndarja nuk mund të urdhërohet për një periudhë që i kalon tridhjetë (30) ditë. Vendimi i tillë rishikohet për aq sa ka nevojë, por të paktën një herë në dhjetë (10) ditë.</p> <p>4. Kur ndarja është urdhëruar për parandalimin e personit të dënuar për të mos ndikuar në personin tjetër të dënuar në shkëljen e rëndë të rendit brenda institucionit korrektues, ose për parandalimin e tij në kryerjen e aktivitetit të vazhdueshëm kriminal në institucionin korrektues, personi i dënuar mund të vendoset në njësi të veçantë të institucionit</p>	<p>2.1. for avoiding danger to life or health of the convicted person or other persons;</p> <p>2.2. for avoiding the danger to the security of the correctional institution caused by the constant presence of the convicted person amongst the convicted persons and other persons in the prison, or</p> <p>2.3. for preserving the integration of investigation into a disciplinary matter.</p> <p>3. The decision from paragraph 1 and 2 of this article is rendered after the investigation of all circumstances. The separation shall not be ordered for a period more than thirty (30) days. Such decision shall be reviewed as often as necessary, but at least once in ten (10) days.</p> <p>4. When the separation was ordered for the detention of a convicted person in order not to instigate another convicted person in the serious violation of the order within correctional institution, or to prevent him from the commission of continuous criminal activity in the correctional institution, convicted person may be placed in a special unit of correctional institution wherein the separation is expected to last longer.</p>	<p>2.1. da se izbegne opasnost po život ili zdravlje osuđenog lica ili drugih lica;</p> <p>2.2. da se izbegne pretnja po bezbednost kazneno popravne ustanove zbog trajnog prisustva osuđenog lica među zatvorenicima i drugim licima u zatvoru, ili</p> <p>2.3. da se obezbedi integritet istrage u vezi nekog disciplinskog pitanja.</p> <p>3.Odluka iz stavova 1 i 2 ovog člana donosi se posle ispitivanja svih relevantnih okolnosti. Odvajanje ne može da se naloži na vreme duže od trideset (30) dana. Takva odluka preispituje se onoliko često koliko bude potrebno, a najmanje jednom u deset (10) dana.</p> <p>4.Kada je odvajanje naloženo radi sprečavanja osuđenog lica da navede drugog osuđenika na težu povredu reda u kazneno popravnoj ustanovi ili radi njegovog sprečavanja na dalje vršenje kriminalnih aktivnosti u kazneno popravnoj ustanovi, osuđeno lice može da bude smešteno u specijalnu jedinicu kazneno popravne ustanove kada se očekuje da to odvajanje potraje duže.</p>
--	--	--

<p>korrektues kur pritet që ndarja të zgjasë shumë.</p> <p>5. Drejtori i institucionit korrektues mund të urdhërojë ndarjen e personit të dënuar i cili sillet në mënyrë të dhunshme ndaj personave tjerë të dënuar, pa kërkesën e tij, për aq sa është e nevojshme të pengojë sjelljen e tij të dhunshme.</p> <p>6. Personit të dënuar, të ndarë prej personave të tjerë të dënuar i njihen të njëjtat të drejta, befinicione dhe kushte sikurse ato të cilat i gëzojnë të gjithë të burgosurit, përveç atyre beneficioneve, të cilat mund të gëzohen vetëm bashkërisht me të burgosurit tjerë, apo të cilat nuk mund të sigurohen për shkak të kufizimeve që i kanë njësitet e institucionit korrektues në të cilin është vendosur personi i dënuar i ndarë.</p> <p>7. Personeli i kualifikuar shëndetësor e kontrollon personin e dënuar të ndarë, së paku një herë në ditë dhe sipas nevojës.</p> <p>8. Vendimi për ndarjen e personit të dënuar nga personat e tjerë të dënuar ndërpritet posa të pushojnë së ekzistuari arsyet për urdhërimin e ndarjes ose në rastet kur personeli i kualifikuar shëndetësor konstaton se vazhdimi i ndarjes do të jetë i dëmshëm për shëndetin e personit të dënuar.</p>	<p>5. Director of correctional institution may order the separation of the convicted person who behaves violently against other convicted persons, without his request, to the extent necessary for preventing such violent behavior of his.</p> <p>6. Convicted person, separated from other convicted persons shall be recognized the same rights, benefits, and conditions as those enjoyed by other prisoners, except those benefits that may be enjoyed only jointly with other prisoners, or those which cannot be ensured due to the restrictions in the units of correctional institution in which the separated convicted person was placed.</p> <p>7. The qualified health personnel shall check the separated convicted person at least once a day and whenever necessary.</p> <p>8. The decision on the separation of the convicted person from other convicted persons shall no longer apply as soon as the reasons for ordering the separation no longer exist, or in the cases when the qualified health personnel determines that the continuation of the separation may be harmful for the health of the convicted person.</p>	<p>5. Direktor kazneno popravne ustanove može da naredi da osuđenik koji se ponaša nasilno prema drugima bude odvojen bez njegovog zahteva, onoliko dugo koliko bude potrebno da se obuzda njegovo nasilno ponašanje.</p> <p>6. Osuđeno lice odvojeno od ostalih osuđenih lica ima ista prava, privilegije i uslove jednake onima koje uživaju svi drugi zatvorenici u kazneno popravnoj ustanovi, osim onih privilegija koje može da uživa samo zajedno sa ostalim zatvorenicima ili onih koje mu se ne mogu omogućiti zbog postojećih ograničenja u jedinici kazneno popravne ustanove u koju je smešteno odvojeno osuđeno lice.</p> <p>7. Kvalifikovano zdravstveno osoblje vrši pregled odvojenog osuđenog lica najmanje jednom dnevno i prema potrebi.</p> <p>8. Odluka o odvajanju osuđenog lica od ostalih osuđenika ukida se čim prestanu da postoje razlozi zbog kojih je odvajanje naređeno ili kad kvalifikovano zdravstveno osoblje utvrdi da bi dalje odvajanje bilo štetno po zdravlje osuđenog lica.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 35 Kontrollimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Search</p>	<p style="text-align: center;">Član 35 Pretrës</p>
<p>1. Personi i dënuar nuk duhet të kontrollohet në mënyrën e cila e cenon dinjitetin e tij. Shkalla e bezdisjes së personit të dënuar gjatë kontrollimit duhet të jetë proporcionale me qëllimin e tij, ashtu siç është paraparë me këtë nen.</p> <p>2. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar ka në posedim ndonjë mjet, i cili atij nuk i lejohet ta ketë në posedim në pajtim me rregullat për rendin e brendshëm mjet i palejuar, personi i dënuar mund të kontrollohet me dorë, ose me mjete teknike derisa është i veshur. Kontrollimi me dorë duhet të bëhet nga anëtari i personelit korrektues të së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar.</p> <p>3. Anëtari i personelit korrektues, mund të kontrollojë trupin e zhveshur të personit të dënuar përmes inspektimit vizual kur nuk ekziston ndonjë dyshim i veçantë në pajtim me kushtet e parapara në paragrafin 6 të këtij neni:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. Në rrethanat e përcaktuara, të parapara në urdhëresë të kufizuara në situata ku personi i dënuar ka qenë në</p>	<p>1. Convicted person shall not be searched in a manner that would violate his dignity. The level of inconvenience caused to the convicted person during the search shall be proportional with its purpose, as specified in this article.</p> <p>2. If a member of the correctional personnel has a grounded suspicion that the convicted person has in his possession an implement, which he is not permitted to possess according to the rules for the internal order for unauthorized things, the convicted person may be searched by hands, or by technical devices while he is dressed. The hand search shall be done by the member of the correctional personnel of the same gender of the convicted person.</p> <p>3. The member of the correctional personnel may search the naked body of the convicted person through visual inspection when there is a particular doubt in accordance with the requirements provided in paragraph 6 of this article:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. in certain circumstances provided in the order restricted to situation when the convicted person was in a place where</p>	<p>1. Način pretresa osuđenog lica ne sme da narušava njegovo dostojanstvo. Invazivnost pretresa osuđenog lica treba da bude proporcionalna njegovoj svrsi kako je propisano ovim članom.</p> <p>2. Ako član osoblja kazneno popravne ustanove opravdano posumnja da osuđeno lice poseduje neki predmet čije mu posedovanje nije dozvoljeno shodno pravilima o unutrašnjem redu, osuđeno lice može da se pretrese ručno ili tehničkim sredstvom dok je odeveno. Ručni pretres vrši član osoblja kazneno popravne ustanove istog pola kao osuđeno lice.</p> <p>3. Član osoblja kazneno popravne ustanove može da izvrši pretres vizuelnim pregledom golog tela osuđenog lica i kad nema posebnih sumnji, u skladu sa uslovima predviđenim u stavu 6 ovog člana:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. u propisanim uslovima utvrđenim naredbom, ograničenim na situacije u kojima je osuđeno lice bilo na mestu</p>

<p>vend ku ka pasur gjasa të ketë qasje në mjetin e palejuar që ka mundësi të fshehët në, apo brenda trupit;</p> <p>3.2.Kur personi i dënuar hyn apo del nga lokalet e personave të dënuar të ndarë.</p> <p>4. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar është në posedim të ndonjë mjeti të palejuar dhe e ka bindur drejtorin e institucionit korrektuese se kontrolli i trupit të zhveshur të personit të dënuar me inspektim vizual është i nevojshëm për gjetjen e mjetit të palejuar, kontrolli i tillë mund të bëhet në pajtim me kushtet e parapara në paragrafin 6 të këtij neni.</p> <p>5. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar posedon ndonjë mjet të palejuar dhe se kontrolli i trupit të zhveshur, të personit të dënuar me inspektim vizual është i nevojshëm për gjetjen e mjetit të palejuar, ai mund të kryejë kontrollin e tillë në pajtim me kushtet e parapara në paragrafin 6 të këtij neni pa miratim paraprak të drejtorit të institucionit korrektuese, nëse vonesa për kërkimin e miratimit të tillë do të rezultonte me rrezik për jetën, apo sigurinë e njeriut.</p>	<p>there was a possibility to have access to unauthorized item that he could hide on or inside his body;</p> <p>3.2.when the convicted person enters into or leaves from the premises of the separated convicted persons.</p> <p>4. If a member of the correctional personnel has a grounded suspicion that the convicted person is in a possession of an unauthorized item and he convinced the director of the correctional institution that the search of the naked body of the convicted person through visual inspection is necessary for finding the unauthorized implement, such search shall be done in accordance with the requirements provided in paragraph 6 of this article.</p> <p>5. If a member of the correctional personnel has a grounded suspicion that the convicted person is in possession of an unauthorized item and that the search of the naked body of the convicted person through visual inspection is necessary for finding the unauthorized implement, he may conduct such a search in accordance with the requirements provided in paragraph 6 of this article without prior approval of the director of correctional institution if the delay in requesting such approval could result in danger to human life or safety.</p>	<p>na kojem je moglo da ima pristup nedozvoljenom predmetu koji može da se sakrije na telu ili u telu; ili</p> <p>3.2.kad osuđeno lice ulazi ili izlazi u prostor sa odvojenim osuđenim licima.</p> <p>4.Ako član osoblja kazneno popravne ustanove opravdano posumnja da osuđeno lice poseduje neki nedozvoljeni predmet i uveri direktora kazneno popravne ustanove da je potreban pretres golog tela osuđenog lica putem vizuelne inspekcije radi pronalaženja nedozvoljenog predmeta, takav pretres može da se izvrši pod uslovima utvrđenim u stavu 6 ovog člana.</p> <p>5.Ako član osoblja kazneno popravne ustanove opravdano posumnja da osuđeno lice poseduje neki nedozvoljeni predmet i da je potreban pretres vizuelnom inspekcijom golog tela osuđenog lica da bi se pronašao nedozvoljeni predmet, on može da izvrši takav pretres u skladu sa uslovima utvrđenim u stavu 6 ovog člana, bez prethodnog odobrenja direktora kazneno popravne ustanove, ako bi odlaganje uzrokovano traženjem tog odobrenja dovelo do opasnosti po život ili bezbednost ljudi.</p>
---	---	--

<p>6.Kontrolli i trupit të zhveshur të personit të dënuar me kontrollim vizual:</p> <p>6.1.Bëhet nga ana e dy (2) punonjësve korrektues të së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar dhe në një vend të veçuar, pa praninë e personave të tjerë;</p> <p>6.2.Asnjëherë nuk bëhet në praninë e personave të gjinisë tjetër nga ajo e personit të dënuar; dhe</p> <p>6.3.Nuk përfshin zhveshjen e pjesëve të sipërme dhe të poshtme të trupit të personit të dënuar në të njëjtën kohë.</p> <p>7. Nëse tek anëtari i personelit korrektues ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar posedon ndonjë mjet të palejuar të fshehur në zgavrat e trupit të tij, ai e informon drejtorin e institucionit korrektues. Nëse drejtori i institucionit korrektues është i bindur se ekziston dyshim i bazuar se personi i dënuar është në posedim të ndonjë mjeti të palejuar të fshehur në zgavrat e trupit të tij dhe se kontrollimi fizik i zgavrave të trupit të tij është i nevojshëm për gjetjen e mjetit të palejuar, drejtori mund të lëshojë autorizim me shkrim për kontrollimin e tillë fizik, me pëlqimin e personit të dënuar. Kontrollimi i</p>	<p>6.The search of naked body of the convicted person through visual inspection:</p> <p>6.1.is conducted by two (2) correctional employees of the same gender as that of the convicted person and in a separate place, without the presence of other persons;</p> <p>6.2.shall never be conducted in the presence of the persons of different gender from that of the convicted person; and</p> <p>6.3.shall not include the stripping of the upper and lower part of the body of the convicted person at the same time.</p> <p>7. If a member of the correctional personnel has a grounded suspicion that the convicted person is in possession of an unauthorized item hidden in the cavities of his body, the member shall inform the director of the correctional institution. If the director of the correctional institution is convinced that there is a grounded suspicion that the convicted person is in possession of such unauthorized item hidden in his cavities and that the physical search of the cavities in his body is necessary for finding the unauthorized implement, the director may issue a written authorization for such physical search, with</p>	<p>6.Pretres vizuelnom inspekcijom golog tela osuđenog lica:</p> <p>6.1.vrše dva (2) radnika kazneno popravne ustanove istog pola kao osuđeno lice i u posebnoj prostoriji bez prisustva ostalih lica;</p> <p>6.2.nikad ne sme da se vrši u prisustvu lica različitog pola od pola osuđenog lica; i</p> <p>6.3.ne uključuje istovremeno razodevanje gornjih i donjih delova tela osuđenog lica.</p> <p>7.Ako član osoblja kazneno popravne ustanove opravdano posumnja da osuđeno lice poseduje nedozvoljeni predmet skriven u telesnim šupljinama, o tome obaveštava direktora kazneno popravne ustanove. Ako se direktor kazneno popravne ustanove uveri da postoji osnovana sumnja da osuđeno lice drži nedozvoljeni predmet skriven u svojim telesnim šupljinama i da je potrebno fizičko ispitivanje njegovih telesnih šupljina da bi se našao nedozvoljeni predmet, direktor može da izda pisano ovlašćenje za takav fizički pretres uz saglasnost osuđenog lica. Takav fizički pretres vrši samo kvalifikovano</p>
--	--	---

<p>tillë fizik kryhet vetëm nga ana e personelit të kualifikuar shëndetësor i së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar në një vend të veçuar.</p> <p>8.Sipas rekomandimit të personelit të kualifikuar shëndetësor me aprovimin e drejtorit të institucionit korrektues, personi i dënuar në trupin e të cilit dyshohet se ka mjete të palejuara dërgohet në institucionin e specializuar mjekësor.</p> <p>9. Çdo send i paautorizuar, i zbuluar si shkak i kontrollit ose ekzaminimit fizik të kaviteteteve të trupit, konfiskohet.</p>	<p>the consent of the convicted person. Such physical search is conducted only by the qualified health personnel of the same gender as that of the convicted person in a separate place.</p> <p>8.Upon the recommendation of the qualified health personnel and approval of the director of correctional institution, the convicted person, in whose body the unauthorized implements are suspected to be, shall be sent to the specialized medical institution.</p> <p>9.Any unauthorized item detected during the search of physical examination of the cavities of the body, shall be confiscated.</p>	<p>zdravstveno osoblje istog pola kao i osuđeno lice, u posebnoj prostoriji.</p> <p>8.Po preporuci kvalifikovanog zdravstvenog osoblja i saglasnosti direktora kazneno-popravne ustanove, ukoliko se sumnja da su neovlašćeni predmeti u telu osuđenog lica, on će biti upućen u specijalizovanu zdravstvenu ustanovu,</p> <p>9.Svaki nedozvoljeni predmet otkriven prilikom pretresa ili fizičkog pretresa telesnih šupljina može da se oduzme.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 36 Strehimi i personave të dënuar</p> <p>1. Personi i dënuar ka të drejtë në strehim që i përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.</p> <p>2. Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar, duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta dhe sasitë mjaftueshme të dritës natyrore dhe</p>	<p style="text-align: center;">Article 36 Accommodation of convicted persons</p> <p>1. Convicted person is entitled to accommodation that meets the contemporary hygienic conditions and local climatic circumstances.</p> <p>2. The premises in which the convicted person shall live and work shall have sufficient space so that each convicted person has at least eight (8) square meters of space for a solitary confinement and four (4) square meters for the convicted persons in joint cells and</p>	<p style="text-align: center;">Član 36 Smeštaj osuđenih lica</p> <p>1.Osuđeno lice ima pravo na smeštaj u skladu sa savremenim higijenskim uslovima i lokalnim klimatskim prilikama.</p> <p>2.Prostorije u kojima osuđeno lice živi i radi moraju da budu dovoljno prostrane da svako osuđeno lice ima na raspolaganju najmanje osam (8) kubnih metara prostora osuđenike u samici a četiri (4) kvadratnih metara za osuđenike u zajedničkim ćelijama i dovoljno</p>

<p>artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.</p> <p>3. Lokalet nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.</p> <p>4. Në lokale të përbashkëta vendosen personat e dënuar, të cilët janë të përshtatshëm për t'u shoqëruar me të tjerët në kushtet e tilla.</p>	<p>sufficient amount of natural and artificial light for work and reading, heating and airing.</p> <p>3. The premises shall be free of humidity and shall be equipped with adequate sanitary equipment and other necessary items for personal hygiene.</p> <p>4. In the joint premises are placed the convicted persons who are suitable to socialize with others in such conditions.</p>	<p>prirodno i veštačko osvetljenje za rad i čitanje, kao i grejanje i ventilaciju.</p> <p>3. Prostorije ne smeju da budu vlažne i moraju da imaju adekvatne sanitarne instalacije i ostale uređaje neophodne za ličnu higijenu.</p> <p>4. U zajedničke prostorije smeštaju se osuđena lica koja su primerena za druženje sa drugima pod tim uslovima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 37 Marrja me ushtrime fizike</p> <p>Personi i dënuar ka të drejtë që të merret me ushtrime fizike aq sa është e nevojshme për ruajtjen e shëndetit të tij dhe të kalojë së paku dy (2) orë në ditë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë. Nëse moti është i mirë, personi i dënuar mund të merret me ushtrime fizike në ambient të hapur.</p>	<p style="text-align: center;">Article 37 Physical exercise</p> <p>Convicted person has the right to physical exercise to the extent necessary for preserving his health and to spend at least (2) hours a day outside the indoor premises during the free time. If the weather is good, the convicted person may do physical exercise in the open air.</p>	<p style="text-align: center;">Član 37 Obavljanje fizičkih vežbi</p> <p>Osuđeno lice ima pravo da fizički vežba u meri potrebnoj za održavanje svog zdravlja i da provede najmanje dva (2) sata dnevno van zatvorenog prostora u slobodnom vremenu. Ako vremenski uslovi dozvoljavaju, osuđeno lice može da se bavi fizičkim vežbama na otvorenom.</p>
<p>2.Me rastin e përfundimit të mbajtjes së dënimit, Shërbimi Korrektues është përgjegjës që të njoftoj të dënuarin për shumën e mjeteve financiare, të cilat i ka realizuar gjatë punës së tij si i dënuar.</p> <p>3.I dënuari brenda periudhës (5) pesë vjeçare pas lirimit, ka të drejtë të kërkoj realizimin e mjeteve financiare të realizuara nga puna e tije si dhe nga cilado forme tjetër e ligjshme. Pas kalimit të këtij afati, nëse mjetet nuk kërkohen nga i dënuari apo përfaqësuesi i autorizuar i tij, të njëjtat barten në buxhetin e Kosovës.</p> <p>4. Drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë shpenzimin e mjeteve nga xhiorllogaria e ruajtjes së parave të kursimit, nëse ato janë të domosdoshme për personin e dënuar, ose për familjen e tij.</p>	<p>2.Upon serving the imprisonment, the Correctional Service is responsible for notifying the convicted person about the amount of money he earned during his work as a convicted person.</p> <p>3. The convicted person shall, within the period of five (5) years after his release, be entitled to request the financial means for the work done or for any other legitimate service. Upon the expiry of such deadline, the financial means, if not requested by the convicted person or his authorized representative, shall be transferred to the Kosovo budget.</p> <p>4. Director of correctional institution may permit the spending of money from the saving account, if that is necessary for the convicted person or his family.</p>	<p>2.Tokom služenja zatvorske kazne, Kazneno popravna ustanova je odgovorna za obaveštavanje osuđenog lica o iznosu novca koji je zarađivao tokom svog rada kao osuđeno lice.</p> <p>3. Osuđeno lice u roku od pet (5) godina nakon puštanja u slobodu ima pravo da zahteva nadoknadu finansijskih sredstava realiziranih iz njegovog rada i bilo kojeg drugog legitimnog oblika. Nakon ovog roka, ako osuđenik ili njegov ovlašćeni predstavnik ne zahtevaju sredstva, iste se prenose u kosovski budžet</p> <p>4.Direktor kazneno popravne ustanove može da odobri trošenje sredstava sa štednog računa ako je to od važnosti za osuđeno lice ili njegovu porodicu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 77 E drejta në beneficione</p> <p>1.Personi i dënuar ka të drejtë në beneficione, në masa mbrojtëse dhe përkujdesje shëndetësore në punën e tij në pajtim me dispozitat e përgjithshme. Për zhdëmtimin e të burgosurve kundër lëndimeve në punë, duke përfshirë edhe sëmundjen profesionale merren masa nën</p>	<p style="text-align: center;">Article 77 The right to benefits</p> <p>1.Convicted person is entitled to benefits, protection measures or healthcare at his work in accordance with the general provisions. For the compensation of the convicted persons for injuries at work, including the occupational illness, measures, which are not less favorable than those provided by the law, shall be taken</p>	<p style="text-align: center;">Član 77 Pravo na beneficije</p> <p>1.Osuđeno lice ima pravo na privilegije, mere zaštite na radu i zdravstvenu zaštitu na radu u skladu sa opštim odredbama o radu. Za obeštećenje zatvorenika u slučaju povrede na radu, uključujući profesionalna oboljenja, preduzimaju se mere pod uslovima koji nisu nepovoljniji od zakonom</p>

<p>kushte jo më pak të favorshme nga ato që i parasheh ligji për punëtorë jashtë institucioneve korrektuese.</p> <p>2.Institucioni korrektues i mbulon nevojat më urgjente të personit të dënuar i cili pa fajin e tij nuk mund të punojë dhe nuk ka mjete të veta.</p> <p>3.Ministri i Drejtësisë nxjerr akt nënligjor për kushtet e punës, duke përfshirë edhe kompensimin në rast të paaftësisë për punë.</p>	<p>for workers outside the correctional institutions.</p> <p>2.Correctional institution shall cover the most emergent needs of the convicted person who without his fault cannot and does not have his own means.</p> <p>3.The Minister of Justice shall adopt a bylaw on work conditions, including the compensation in case of incapacity to work.</p>	<p>predvidenih uslova za radnike van kazneno popravnom službom.</p> <p>2.Kazneno popravna ustanova pokriva najhitnije potrebe osuđenog lica koje bez svoje krivice ne može da radi i nema svoja novčana sredstva.</p> <p>3.Ministar pravde donosi podzakonski akt o uslovima rada, uključujući naknadu u slučaju nesposobnosti za rad.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 78 Orari maksimal i punës ditore ose javore për personat e dënuar</p>	<p style="text-align: center;">Article 78 Maximum working hours of daily or weekly work for convicted persons</p>	<p style="text-align: center;">Član 78 Maksimalno radno vreme dnevno ili nedeljno za osuđenih lica</p>
<p>1.Orari maksimal i punës ditore ose javore për personat e dënuar caktohet në pajtim me dispozitat e përgjithshme të punës. Ky orar parasheh një (1) ditë pushim në javë dhe kohë të mjaftueshme për arsimim dhe aktivitete të tjera të domosdoshme për korrektimin dhe risocializimin e personave të dënuar.</p> <p>2.Personi i dënuar që ka punuar më tepër se gjashtë (6) muaj gjatë qëndrimit në institucionin korrektues ka të drejtë në pushim vjetor në pajtim me dispozitat e përgjithshme të punës.</p>	<p>1.The maximum working hours of daily or weekly work for convicted persons shall be set in accordance with the general provisions of labor. This working schedule provides for one (1) day off a week and sufficient time for education and other activities necessary for the correction and resocialization of the convicted persons.</p> <p>2.Convicted person who worked more than six (6) months during his stay in the correctional institution is entitled to annual leave in accordance with the general provisions of labor.</p>	<p>1.Najduže dnevno i nedeljno radno vreme osuđenih lica utvrđuje se u skladu sa opštim odredbama o radu. Radno vreme mora da omogući jedan (1) dan odmora nedeljno i dovoljno vremena za obrazovne i ostale aktivnosti koje su neophodne kao deo resocijalizacije osuđenih lica.</p> <p>2.Osuđeno lice koje je radilo više od šest (6) meseci za vreme boravka u kazneno popravnoj ustanovi ima pravo na godišnji odmor u skladu sa opštim odredbama o radu.</p>

<p>3. Personi i dënuar shpërblehet gjatë periudhës së pushimit vjetor sikurse të punonte.</p> <p style="text-align: center;">Neni 79 Të drejtat e punës së femrës së dënuar për shkak të shtatzënësisë, lindjes dhe amësisë</p> <p>Femra e dënuar ka të drejtë të mos punojë për shkak të shtatzënësisë, lindjes dhe amësisë, në pajtim me dispozitat e përgjithshme të punës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 80 Të drejtat lidhur me shpikjet dhe inovacionet teknike</p> <p>1. Personi i dënuar i gëzon të gjitha të drejtat në pajtim me dispozitat e përgjithshme lidhur me shpikjet dhe inovacionet teknike të arritura gjatë mbajtjes së dënimit.</p> <p>2. Veprat artistike dhe veprat tjera krijuese të realizuara nga personi i dënuar gjatë kohës së lirë janë pronë e tij intelektual.</p> <p style="text-align: center;">Neni 81 Aftësimi profesional</p> <p>Personave të dënuar, institucioni korrektues u ofron mundësi për vijimin e aftësisë</p>	<p>3. Convicted person shall be remunerated during the annual leave same as when working.</p> <p style="text-align: center;">Article 79 Working rights of convicted female due to pregnancy, childbirth and maternity</p> <p>A convicted female is entitled not to work due to her pregnancy, childbirth and maternity, in accordance with the general provisions of labor.</p> <p style="text-align: center;">Article 80 Rights related to inventions and technical innovations</p> <p>1. Convicted person enjoys all the rights in accordance with the general provision related to the inventions and technical innovations made during the imprisonment.</p> <p>2. Artistic works and other creative works performed by the convicted person during his free time are his intellectual property.</p> <p style="text-align: center;">Article 81 Vocational training</p> <p>The correctional institution shall enable the convicted persons an opportunity to attend</p>	<p>3. Osuđeno lice dobija novčanu naknadu za vreme svog godišnjeg odmora kao da je radilo.</p> <p style="text-align: center;">Član 79 Prava rada za osuđenu ženu zbog trudnoće, porođaja i materinstva</p> <p>Osuđena žena ima pravo da ne radi zbog trudnoće, porođaja i materinstva u skladu sa opštim odredbama o radu.</p> <p style="text-align: center;">Član 80 Prava u vezi sa pronalascima i tehničkim inovacijama</p> <p>1. Osuđeno lice ima sva prava shodno opštim odredbama u vezi sa pronalascima i tehničkim inovacijama ostvarenim u periodu izdržavanja kazne.</p> <p>2. Umetnička i druga stvaralačka dela koja osuđeno lice proizvede u svoje slobodno vreme su njegova intelektualna svojina.</p> <p style="text-align: center;">Član 81 Stručna obuka</p> <p>Kazeno popravna institucija pruža osuđenim licima mogućnost za pohađanje</p>
---	--	---

<p>profesional në përmirësimin e shkathtësive të tyre ose përvetësimin e shkathtësive të reja.</p> <p style="text-align: center;">Neni 82 Organizimi i kurseve për aftësim profesional</p> <p>Organet publike kompetente përgjegjëse për arsimin publik dhe punën bashkëpunojnë në organizimin e kurseve për aftësimin profesional.</p> <p style="text-align: center;">Neni 83 Mbajtja e kurseve për aftësimin profesional</p> <p>Kurset për aftësimin profesional mbahen gjatë orarit të punës. Personi i dënuar, i cili nuk punon si pasojë e pjesëmarrjes në kurse për aftësimin profesional ka të drejtë në ndihmë financiare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 84 Arsimimi</p> <p>1. Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin për arsimin parauniversitar.</p>	<p>vocational training for the improvement of their abilities or acquisition of new skills.</p> <p style="text-align: center;">Article 82 Organization of vocational training courses</p> <p>Competent public bodies, which are responsible for public education and work shall cooperate in the organization of vocational training courses.</p> <p style="text-align: center;">Article 83 Attendance of vocational training courses</p> <p>The vocational training courses shall be attended during the working hours. The convicted person who does not work as a result of his participation in the vocational training courses is entitled to financial aid.</p> <p style="text-align: center;">Article 84 Education</p> <p>1. Convicted person is entitled to primary and secondary education in accordance with the law on pre-university education.</p>	<p>stručne obuke kako bi unapredili svoje veštine ili naučili nove.</p> <p style="text-align: center;">Član 82 Organizovanje kurseva za stručno obrazovanje</p> <p>Nadležni javni organi zaduženi za javno obrazovanje i rad sarađuju u organizovanju kurseva stručne obuke.</p> <p style="text-align: center;">Član 83 Održavanje kurseva za stručno obrazovanje</p> <p>Kursevi stručne obuke održavaju se tokom radnog vremena. Osuđeno lice koje ne radi zbog pohađanja kurseva stručne obuke ima pravo na novčanu pomoć.</p> <p style="text-align: center;">Član 84. Obrazovanje</p> <p>1. Osuđeno lice ima pravo na osnovno i srednje obrazovanje u skladu sa Zakonom o osnovnom i srednjem obrazovanju.</p>
---	---	---

<p>2.Shërbimi Korrektues është përgjegjës për caktimin e lokacionit dhe infrastrukturës ku do të zhvillohet mësimi.</p> <p>3.Përgjegjës për arsimimin fillor dhe të mesëm në institucionin korrektues është Ministria kompetente për arsim.</p> <p>4.Për personat e dënuar që nuk dinë shkrim lexim organizohen kurse të posaçme.</p> <p>5.Personat e dënuar sa të jetë e mundur ndihmohen në vijimin e kurseve arsimore që ofrohen përmes postës, radios, ose televizionit.</p> <p>6.Institucioni korrektues organizon edhe forma të tjera të arsimimit për personat e dënuar.</p> <p>7.Drejtori i Institucionit Korrektues, mund t'i mundëson personit të dënuar vijimin e trajnimeve specifike, duke përfshirë edhe arsimimin universitar.</p> <p>8.Çështjet tjera lidhur me arsimin sipas këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor, të cilin e miraton Qeveria.</p>	<p>2.Correctional Service is responsible for providing the location and infrastructure where education will take place.</p> <p>3.The competent ministry for education is responsible for primary and secondary education in the correctional institution.</p> <p>4.For illiterate convicted persons special courses shall be organized.</p> <p>5.The convicted person as much as possible shall be assisted in attending the education courses provided through mail, radio and television.</p> <p>6.Correctional institution shall organize other forms of education for convicted persons.</p> <p>7.Director of correctional institution may enable the convicted person to attend specific trainings, including the university education.</p> <p>8.Other matters related to education under this article shall be governed by a bylaw adopted by the Government.</p>	<p>2.Kazнено popravna služba je odgovorna za određivanje lokacije i infrastrukture gde će se obavljati nastava.</p> <p>3.Odgovorno za osnovno i srednje obrazovanje u kazнено popravnoj ustanovi je ministarstvo nadležno za obrazovanje.</p> <p>4.Za nepismena osuđena lica organizuju se posebni kursevi.</p> <p>5.Osuđenim licima se pomaže koliko je god moguće da pohađaju obrazovne kurseve putem pošte, radija ili televizije.</p> <p>6.Kazнено popravna ustanova organizuje i druge vidove obrazovanja za osuđena lica.</p> <p>7.Direktor Kazнено popravne ustanove može osuđenom licu omogućiti da prisustvuje u određenim obukama, uključujući i visokoškolsko obrazovanje.</p> <p>8.Druga pitanja koja se odnose na obrazovanje po ovom članu uređuju se podzakonskim aktom koji je usvojila Vlada.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 85 Vijimi i kurseve arsimore gjatë orarit të punës</p> <p>Vijimi i kurseve arsimore bëhet gjatë orarit të punës. Personi i dënuar që nuk punon për shkak të vijimit të kurseve arsimore ka të drejtë në kompensim.</p>	<p style="text-align: center;">Article 85 Attendance of educational courses during the working hours</p> <p>The educational courses shall be attended during the working hours. The convicted person who does not work due to the attendance of the education courses is entitled to compensation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 85 Pohađanje u obrazovnim kursevima tokom radnog vremena</p> <p>Pohađanje kurseva stručne obuke obavlja se tokom radnog vremena. Osuđeno lice koje ne radi zbog pohađanja kursa stručne obuke ima pravo na naknadu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 86 Dokumenti pas përfundimit të aftësimit profesional ose kurseve arsimore</p> <p>Në dokumentin e lëshuar pas përfundimit të aftësimit profesional, ose kurseve arsimore nuk shënohet se kurset janë kryer gjatë qëndrimit të personit të dënuar në institucionin korrektues.</p>	<p style="text-align: center;">Article 86 Document after the completion of vocational training or education courses</p> <p>The document issued after the completion of the vocational training or education courses shall describe that the courses were completed during the stay of the convicted person in the correctional institution.</p>	<p style="text-align: center;">Član 86 Dokumenat nakon završetka stručnog ili obrazovnog kursa</p> <p>U dokumentu koji se izdaje po završetku stručne obuke ili obrazovnih kurseva ne može da piše da je kurs završen u toku boravka osuđenog lica u kazneno popravnoj ustanovi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 87 Informimi</p> <p>1. Personi i dënuar ka të drejtë të ketë qasje në shtypin ditor dhe atë periodik në gjuhën e tij amtare dhe në burime të tjera të informimit publik.</p> <p>2. Personi i dënuar ka të drejtë të ketë qasje në programet e radios dhe të televizionit. Gjatë zgjedhjes së programeve merret</p>	<p style="text-align: center;">Article 87 Information</p> <p>1. Convicted person is entitled to have access to daily and periodic press in his mother language and to other sources of public information.</p> <p>2. Convicted person is entitled to have access to radio and television programs. In selecting the programs, the preference of convicted</p>	<p style="text-align: center;">Član 87 Informisanje</p> <p>1. Osuđeno lice ima pravo na pristup dnevnoj i periodičnoj štampi na maternjem jeziku i ostalim izvorima javnog informisanja.</p> <p>2. Osuđeno lice ima pravo na pristup radio i televizijskim programima. Pri izboru programa uzimaju se u obzir sklonosti</p>

<p>parasysh parapëlqimi i personave të dënuar, si dhe nevojat e tyre arsimore dhe rekreative.</p> <p>3.Të gjitha institucionet korrektuese pajisen me bibliotekë për t'u shfrytëzuar nga personat e dënuar. Biblioteka përmban libra (duke përfshirë tekste bazike mbi të drejtat e njeriut dhe ligjet penale), revista dhe gazeta në gjuhën amtare që personave të dënuar u mundësojnë alternativa të shumta.</p> <p>4.Librat, revistat dhe gazetat në bibliotekë zgjidhen në atë mënyrë për të përmirësuar nivelin e njohurive të personave të dënuar, për të zhvilluar aftësitë e tyre për qëndrim kritik ndaj ngjarjeve ditore, si dhe për t'u ofruar rekreacion.</p> <p>5.Personi i dënuar ka të drejtë të lexojë libra nga biblioteka e institucionit korrektues dhe libra të siguruara nga ai. Shërbimi Korrektues mund të kufizoj qasjen në literaturë, e cila është e rrezikshme për sigurinë e ambienteve të institucionit korrektues apo për sigurinë e ndonjë personi, e cila inkurajon urrejtjen apo dhunën përmban materiale pornografike, apo të cilat në çfarëdo mënyre ndikojnë në paraqitjen e çrregullimeve apo formave të ndryshme të kriminalitetit.</p>	<p>persons and their education and recreational needs shall be taken into consideration.</p> <p>3.All correctional institutions are equipped with library to be used by the convicted persons. The library contains books (including basic texts on human rights and criminal laws), magazines and newspapers in mother language that provide many alternatives for the convicted persons.</p> <p>4.Books, magazines and newspapers in the library are selected in that manner as to improve the level of knowledge of convicted persons, in order to develop their abilities on the critical opinion about daily events and to meet their leisure needs.</p> <p>5.Convicted person is entitled to read books from the library of the correctional institution and books provided by him. Correctional Service may restrict the access to literature which is dangerous to the security of the premises of the correctional institution or security of any person, which incites hatred or violence, which contains pornographic material, or which in any way influence the appearance of disorders or various forms of criminality.</p>	<p>osudehnh lica i njihove obrazovne i rekreativne potrebe.</p> <p>3.Sve kazneno popravne ustanove moraju da imaju biblioteku koja stoji na raspolaganju osudehnh licima. Biblioteka mora da bude opremljena knjigama (ukljucujući osnovnu literaturu o ljudskim pravima i krivicnhim zakonima), časopisima i dnevnom štampom na maternjem jeziku osudehnh lica kako bi osudehnicima bila pružena mogućnost izbora.</p> <p>4.Izbor knjiga, časopisa i dnevne štampe mora da bude takav da unapredi nivo znanja osudehnh lica, da razvije njihovu sposobnost kritičkog pristupa dnevnhim događajima i da im pruži mogućnost rekreacije.</p> <p>5.Osudeho lice ima pravo da čita knjige iz biblioteke kazneno popravne ustanove i knjige do kojih je samo došlo. Kazneno popravna služba može da ograniči pristup literaturi koja je opasna za bezbednost okruženja kazneno popravne ustanove ili za bezbednost ljudi, koja podstiče mržnju ili nasilje, sadrži pornografski materijal ili koja na bilo koji način utiču na nastupanje poremećaja ili raznih oblika kriminaliteta.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 88 Aktivitetet kulturore, rekreative dhe sportive</p> <p>1. Aktivitetet kulturore, rekreative dhe sportive, si dhe aktivitetet tjera që synojnë zhvillimin e personalitetit të personit të dënuar organizohen brenda institucioneve korrektuese me ndihmën e subjekteve publike dhe private të interesuara për riintegrimin e personave të dënuar në shoqëri.</p> <p>2. Pjesëmarrja aktive e personave të dënuar në organizimin e aktiviteteve kulturore, rekreative dhe sportive inkurajohet pa prishur rendin dhe sigurinë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 88 Cultural, recreational and sport activities</p> <p>1. Cultural, recreational and sport activities as well as other activities that aim at the development of the personality of the convicted person shall be organized inside the correctional institution with the assistance of the public and private entities interested in the reintegration of the convicted person in the community.</p> <p>2. The active participation of convicted persons in the organization of cultural, recreational and sport activities is encouraged without disturbing public peace and order.</p>	<p style="text-align: center;">Član 88 Kulturne, rekreative i sportske aktivnosti</p> <p>1. Kulturne, rekreative i sportske aktivnosti, kao i druge aktivnosti čiji je cilj razvoj ličnosti osuđenog lica, organizuju se u kazneno popravnoj ustanovi uz pomoć javnih i privatnih subjekata zainteresovanih za reintegraciju osuđenih lica u društvo.</p> <p>2. Podstiče se aktivno učešće osuđenih lica u organizovanju kulturnih, rekreativnih i sportskih događaja bez narušavanja reda i bezbednosti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 89 E drejta për ushtrimin e fesë</p> <p>1. Personi i dënuar ka të drejtë të marrë pjesë në ceremoni fetare dhe të lexojë literaturë fetare.</p> <p>2. E drejta për t'u vizituar nga përfaqësuesi kompetent i fesë përkatëse nuk mund të kufizohet. Koha e vizitave përcaktohet me aktin për rendin shtëpiak.</p> <p>3. Me kërkesë të personave të dënuar, drejtori i institucionit korrektues mund të caktojë</p>	<p style="text-align: center;">Article 89 The right to exercise religion</p> <p>1. Convicted person is entitled to participate in religious ceremony and read religious literature.</p> <p>2. The right of visit by the competent representative of respective religion shall not be restricted. The visiting time shall be governed by the decree on house order.</p> <p>3. Upon the request of convicted persons, the director of correctional institution may</p>	<p style="text-align: center;">Član 89 Pravo na veroispovest</p> <p>1. Osuđeno lice ima pravo da učestvuje u verskim obredima i da čita versku literaturu.</p> <p>2. Pravo na posete zvaničnih verskih predstavnika ne može da bude ograničeno. Vreme posete određeno je aktom o kućnom redu.</p> <p>3. Na zahtev osuđenih lica direktor kazneno popravne ustanove može da organizuje</p>

<p>vizita të rregullta të përfaqësuesit kompetent të fesë përkatëse në institucionin korrektues, nëse numri i personave të dënuar të të njëjtit besim fetar e arsyeton këtë.</p> <p>4.Drejtori i institucionit korrektues përkohësisht mund t'i përjashtojë personat e dënuar nga ceremonitë fetare, nëse përjashtimi i tillë është i nevojshëm për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë dhe lidhur me këtë njoftohet përfaqësuesi kompetent i fesë.</p> <p>5.Ceremonitë fetare mbahen në lokale të veçanta të përshtatshme të institucionit korrektues.</p>	<p>schedule regular visits of the competent representative of the respective religion in the correctional institution, if the number of convicted person of the same religion justifies it.</p> <p>4.Director of correctional institution may temporarily deprive the convicted persons of the religious ceremonies, if such action is necessary for preserving order and security and the competent representative of the religion shall be notified about it.</p> <p>5.The religious ceremonies are held in separate and suitable facilities of the correctional institution.</p>	<p>redovne posete zvaničnog verskog predstavnika kazneno popravnoj ustanovi, ako postoji dovoljan broj osuđenih lica iste veroispovesti.</p> <p>4.Direktor kazneno popravne ustanove može da privremeno isključi osuđena lica iz verskih obreda ako je takvo isključenje neophodno da se održi red i bezbednost, a zvanični verski nadležni predstavnik biva o tome obavješten.</p> <p>5.Verski obredi održavaju se u posebnim odgovarajućim prostorijama kazneno popravne ustanove.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 90 Vizita dhe pushimi për rastet e jashtëzakonshme</p> <p>1.Në rast të sëmundjes së rëndë ose të rrezikut të drejtpërdrejtë të vdekjes, a të vdekjes së një anëtarit të familjes, drejtori i institucionit korrektues mund t'i lejoj personit të dënuar vizitë apo pushim në pajtim me aktin për rendin shtëpiak.</p> <p>2.Drejtori i institucionit korrektues mund të caktojë kushte, të cilat ai i konsideron të arsyeshme dhe të nevojshme për mbrojtjen e rrethit shoqëror me rastin e lejimit të</p>	<p style="text-align: center;">Article 90 Visit and leave for extraordinary cases</p> <p>1.In case of serious illness or direct danger to life, or death of a family member, the director of correctional institution may permit the convicted person to visit to take a leave in accordance with the decree on house order.</p> <p>2.Director of correctional institution may set conditions that he considers are reasonable and necessary for the protection of the community when permitting such a leave</p>	<p style="text-align: center;">Član 90 Odsustvo zbog vanrednih slučajeva</p> <p>1.U slučaju teže bolesti ili neposredne opasnosti od smrti ili smrti člana porodice, direktor kazneno popravne ustanove može osuđenom licu da odobri odsustvo u skladu sa aktom o kućnom redu.</p> <p>2.Direktor kazneno popravne ustanove može da utvrdi uslove koje smatra razumnim i potrebnim radi zaštite društva, prilikom odobravanja odsustva na osnovu ovog člana,</p>

<p>pushimit në pajtim me këtë nen, duke përfshirë edhe urdhrin që personi i dënuar të shoqërohet gjatë pushimit nga zyrtarët korrektues.</p> <p>3.Pushimi i pa caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk mund të jetë më i gjatë se shtatë (7) ditë.</p>	<p>under this article, including the order that correction officers accompany the convicted person during the leave.</p> <p>3.The unspecified leave under paragraph 1 of this article shall not be longer than seven (7) days.</p>	<p>uključujući naređenje da osuđenik dok je na odsustvu bude u pratnji člana osoblja kazneno popravne ustanove.</p> <p>3.Odsustvo koje nije određeno stavom 1 ovog člana ne može biti duže od sedam (7) dana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 91 Ankesat dhe kërkesat</p>	<p style="text-align: center;">Article 91 Complaints and claims</p>	<p style="text-align: center;">Član 91 Molbe i pritužbe</p>
<p>1.Personi i dënuar njoftohet mbi të drejtat dhe detyrimet e të burgosurve dhe lidhur me procedurat e paraqitjes së ankesave dhe kërkesave.</p>	<p>1.Convicted person shall be notified about the rights and obligations of the convicted persons and about the procedure for filing complaints and claims.</p>	<p>1.Osuđeno lice se obaveštava o pravima i obavezama zatvorenika i o postupku za podnošenje molbi i pritužbi.</p>
<p>2. Personi i dënuar ka të drejtë ankese në procedurën dhe vendimin të punësuarve në institucionet korrektuese. Ankesa paraqitet gojarisht apo me shkrim nëpërmes drejtorit të institucionit korrektues, Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues. Ankimi me shkrim, Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues i dërgohet në mbështjellës, të cilën drejtorja e institucionit korrektues nuk guxon ta hap.</p>	<p>2. Convicted person is entitled to complain against the procedure and decision of the employees in the correctional institutions. The complaint is made verbally or in writing through the director of the correctional institution to the general director of the correctional service. The written complaint addressed to the general director of the correctional service shall be sealed and the directorate of the correctional institution must not open it.</p>	<p>2.Osuđeno lice ima pravo na pritužbu na postupak i odluke zaposlenih u kazneno popravnoj ustanovi. Pritužbu može da podnese usmeno ili u pisanoj formi, preko direktora kazneno popravne ustanove, za Centralnu kancelariju Kazneno popravne službe. Pisana pritužba Centralnoj kancelariji se šalje u zatvorenoj kovrti koju direktor kazneno popravne ustanove ne sme da otvori.</p>
<p>3. Personit të dënuar duhet t'i mundësohet që ankimin gojor ta paraqes pa praninë e të punësuarit të institucionit korrektues apo pa</p>	<p>3. Convicted person shall be enabled to make the verbal complaint without the presence of the employee of the correctional institution or</p>	<p>3.Osuđenom licu se mora omogućiti da iznese usmenu pritužbu bez prisustva zaposlenih kazneno popravne ustanove</p>

<p>pranin e personit kundër procedurave dhe vendimeve të të cilit është paraqitur ankimi.</p> <p>4. Në ankesën e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim.</p> <p>5. Personi i dënuar ka të drejtë të parashtrojë ankesë te drejtori i institucionit korrektues lidhur me shkeljen e të drejtave të tij, ose me parregullsitë e tjera që i janë bërë atij në institucionin korrektues.</p> <p>6. Drejtori i institucionit korrektues ose personi i autorizuar nga ai është i obliguar që t'i përgjigjet me shkrim.</p> <p>7. Drejtori i institucionit korrektues, ose personi i autorizuar nga ai është i obliguar që:</p> <p>7.1.T'i regjistrojë të gjitha ankimet dhe masat që janë ndërmarrë për trajtimin e tyre;</p> <p>7.2.T'i shqyrtojë menjëherë ankesat dhe personit të dënuar t'ia dorëzojë vendimin lidhur me ankimin;</p>	<p>without the presence of the person against whose procedures and decisions the complaint is made.</p> <p>4. To the filed complaint the director of correctional institution shall reply within fifteen (15) days, whereas the general director of the correctional service within thirty (30) days. To the complaint in writing a reply in writing shall be made.</p> <p>5.Convicted person is entitled to file a complaint to the Director of correctional institution concerning the violation of his rights or other irregularities against him in the correctional institution.</p> <p>6. Director of correctional institution, or his authorized representative is obliged to reply in writing.</p> <p>7. Director of correctional institution, or his authorized representative is obliged to:</p> <p>7.1.register all complaints and measures taken to handle them;</p> <p>7.2.immediately review the complaints and to serve the decision</p>	<p>odnosno bez prisustva lica protiv čijeg je postupka i odluke podneo pritužbu.</p> <p>4.Na podnetu pritužbu direktor kazneno popravne ustanove treba da odgovori u roku od petnaest (15) dana, dok Centralna kancelarija Kazneno popravne službe treba da odgovori u roku od trideset (30) dana. Na pritužbu podnetu u pisanoj formi daje se odgovor u pisanoj formi.</p> <p>5.Osuđeno lice ima pravo da podnese pritužbu direktoru kazneno popravne ustanove zbog kršenja njegovih prava ili drugih nepravilnosti koje su njemu pričinjene u kazneno popravnoj ustanovi.</p> <p>6.Direktor kazneno popravne ustanove ili lice koje je on ovlastio dužni su da odgovore u pisanoj formi.</p> <p>7.Direktor kazneno popravne ustanove ili lice koje on ovlasti dužni su da:</p> <p>7.1.evidentiraju sve pritužbe i svaku meru preduzetu u vezi sa rešavanjem istih;</p> <p>7.2.pritužbe odmah razmatraju i uruče osuđenom licu odluku povodom pritužbe;</p>
--	---	--

<p>7.3.Nëse ankimi ka të bëjë me sulmin e pohuar, të sigurojë që personi i dënuar t'i nënshtrohet kontrollit të menjëhershëm mjekësor dhe trajtimit të rekomanduar dhe</p> <p>7.4. T'ia paraqesë veprat penale prokurorit të shtetit në pajtim me dispozitat kreut përkatës për kallëzimin penal të Kodit të Procedurës Penale.</p> <p>8. Nëse personi i dënuar nuk merr përgjigje në ankesën e tij, ose nuk është i kënaqur me përgjigjen e marrë, ai ka të drejtë që Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues t'i dorëzojë ankesë me shkrim, i cili organ e shqyrton ankesën dhe përgjigjen lidhur me këtë ia dërgon personit të dënuar.</p> <p>9.Personi i dënuar, i pa kënaqur me përgjigjen e pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues ka të drejtë t'i parashtojë ankesë Ministrit.</p> <p>10.Përmbajtja e ankesës dhe e kërkesës është konfidenciale.</p>	<p>on the complaint on the convicted person;</p> <p>7.3.if complaint relates to an alleged assault, to ensure that the convicted person undergoes immediate medical examination and recommended treatment, and</p> <p>7.4. present the criminal offences to the state prosecutor in accordance with the provisions for the criminal charges under the Criminal Procedure Code.</p> <p>8. If convicted person does not receive a reply to his complaint, or is not satisfied with the received reply, he has the right to submit a complaint in writing to the general director of the correctional service, which is the body that will review the complaint and serve the reply on the convicted person.</p> <p>9.Convicted person, who is not satisfied with the reply of the general director of the correctional service is entitled to file a complaint to the Minister.</p> <p>10.The content of the complaint and the claim shall remain confidential.</p>	<p>7.3.ako se pritužba odnosi na navodni napad, obezbede da osuđeno lice odmah bude podvrgnuto lekarskom pregledu i preporučenom tretmanu; i</p> <p>7.4.prijave krivično delo državnom tužiocu u skladu sa odredbama odgovarjućeg poglavlja o krivičnoj prijavi Zakonika o krivičnom postupku.</p> <p>8.Ako osuđeno lice ne dobije odgovor na pritužbu ili nije zadovoljno dobijenim odgovorom, ima pravo da podnese pisanu pritužbu generalnom direktoru Kazneno popravne službe, koji zatim razmatra pritužbu i odgovor u vezi sa istom dostavlja osuđenom licu.</p> <p>9.Osuđeno lice nezadovoljno odgovorom generalnog direktora Kazneno popravne službe ima pravo da uložiti žalbu ministru.</p> <p>10.Sadržina pritužbe i molbe je poverljiva.</p>
---	---	--

<p align="center">Neni 92 Beneficionet e personave të dënuar</p>	<p align="center">Article 92 Benefits of convicted persons</p>	<p align="center">Član 92 Privilegije osuđenog lica</p>
<p>1.Për sjellje të mirë dhe angazhim në punë, drejtori i institucionit korrektues pas marrjes së rekomandimit të ekipit për planifikimin e dënimit mund t'i japë beneficione vijuese personit të dënuar:</p> <p>1.1.Të drejtën e zgjeruar në pranimin e vizitave duke përfshirë vizitat nga rrethi i gjerë i personave;</p> <p>1.2.Pranimin e vizitave në institucionin korrektues në prani të mbikëqyrësve, por pa u dëgjuar nga ata;</p> <p>1.3.Të drejtën e zgjeruar në kalimin e kohës së caktuar në lokale të veçanta me bashkëshortin/en, prindërit dhe fëmijët</p> <p>1.4.Të drejtën e zgjeruar në thirrje telefonike.</p> <p>1.5.Të drejtën e shfrytëzimit të pushimit vjetore prej shatë (7) ditësh jashtë institucionit korrektues, nga pushimi vjetor prej tetëmbëdhjete (18) ditësh.</p>	<p>1.For good conduct and commitment to work, the director of correctional institution, with the recommendation of the imprisonment planning team, may provide the convicted person with the following benefits:</p> <p>1.1.the extended right to receiving visits including the visits from the wide circle of persons;</p> <p>1.2.receiving visits in the correctional institution in the presence of the supervisors, but without being heard by them;</p> <p>1.3.the extended right to spend certain time in separate facilities with the spouse, parents and children</p> <p>1.4.the extended right to phone call.</p> <p>1.5.The right to use the annual leave of seven (7) days outside the correctional institution from the annual leave of eighteen (18) days.</p>	<p>1.Direktor kazneno popravne ustanove može, na preporuku tima za planiranje izdržavanja kazne, osuđenom licu koje se dobro ponaša i vredno radi da dodeli sledeće privilegije:</p> <p>1.1.veće pravo na posete, uključujući posete šireg kruga ljudi;</p> <p>1.2.primanje poseta u kazneno popravnoj ustanovi, gde će nadzornici biti prisutni ali neće moći da ga slušaju;</p> <p>1.3.prošireno pravo boravka za određeno vreme u posebnim prostorijama sa suprugom, roditeljima i decom;</p> <p>1.4.veće pravo na telefonske pozive;</p> <p>1.5.pravo na korišćenje godišnjeg odmora od sedam (7) dana izvan kazneno popravne ustanove od godišnjeg odmora od osamnest (18) dana.</p>

<p>1.6.Pushimin jashtë institucionit korrektues deri në shtatë (7) ditë për çdo vit;</p> <p>2. Të drejtën e shfrytëzimit të beneficioneve nga paragrafi 1.5 dhe 1.6, të këtij neni e fitojnë personat që plotësojnë kushtet, si në vijim:</p> <p>2.1.Nëse është i dënuar më shumë se pesë (5) vjet burgim, mund të jepet leja për pushim pasi t'i ketë mbajtur dy të tretat (2/3) e dënimit të shqiptuar;</p> <p>2.2. Nëse është i dënuar më me pak se pesë (5) vjet, mund t'i jepet leja për pushim pasi ta ketë mbajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar;</p> <p>3. Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të beneficioneve nga neni 90, 91 dhe 92, i këtij ligji përcaktohen me aktin për rendin shtëpiak.</p> <p style="text-align: center;">Neni 93 Transferimi i personave të dënuar</p> <p>1.Personi i dënuar mund të transferohet nga një institucion korrektues në tjetrin, ose nga</p>	<p>1.6.Leave outside the correctional institution up to seven (7) days a year;</p> <p>2. The right to use the benefits from paragraph 1.5 and 1.6 of this article shall be enjoyed by the persons who meet the following requirements:</p> <p>2.1. If he is sentenced to more than five (5) years of imprisonment, a leave of absence may be granted after having served two-thirds of his sentence;</p> <p>2.2.If the convicted person is punished by imprisonment of less than five (5) years, the leave permit may be granted after half of the imprisonment has been served;</p> <p>3. The conditions and the manner of using the benefits from articles 90, 91 and 92 of this law shall be governed by the decree on house order.</p> <p style="text-align: center;">Article 93 Transfer of convicted persons</p> <p>1.Convicted person may be transferred from one correctional institution to another, or from</p>	<p>1.6.Pravo da bude izvan kazneno popravne ustanove do sedam (7) dana u godini;</p> <p>2. Pravo na korišćenje privilegija iz stava 1.5 i 1.6 ovog člana uživaju lica koja ispunjavaju sledeće uslove:</p> <p>2.1. Ako je osuđen na više od pet (5) godina zatvora, može se odobriti dozvola za odmor nakon zadržavanja dve trećine.</p> <p>2.2. Ako se osuđeno lice kažnjava kaznom zatvora manjom od pet (5) godina, dozvola za odsustvo može se odobriti nakon izdržavanja polovine kazne zatvora.</p> <p>3. Uslovi i način korišćenja privilegija iz članova 90, 91 i 92 ovog zakona uređuju se uredbom o kućnom redu.</p> <p style="text-align: center;">Član 93 Premeštaj osuđenih lica</p> <p>1.Osuđeno lice može da bude premešteno iz jedne kazneno popravne ustanove u drugu ili</p>
---	---	--

<p>një njësi e institucionit korrektues në tjetrën, nëse kjo është e nevojshme:</p> <p>1.1.Për zbatimin e programit të tij korrektues dhe risocializues ose programin e punës;</p> <p>1.2.Për inkurajimin e kontakteve ndërmjet personit të dënuar dhe familjes së tij dhe rrethit shoqëror, me qëllim të lehtësimit të riintegrit të tij përfundimtar në shoqëri;</p> <p>1.3.Për shkaqet e mbrojtjes dhe sigurisë të personit të dënuar;</p> <p>1.4.Në interes të ruajtjes së rendit dhe disiplinës brenda institucionit korrektues;</p> <p>1.5.Për shkak të trajtimit shëndetësor.</p> <p>2.Vendimin për transferimin e personit të dënuar e merr Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues me propozim të drejtorit të institucionit korrektues ose në bazë të kërkesës së personit të dënuar apo të ndonjë anëtari të ngushtë të familjes.</p> <p>3.Në rast të transferimit, të cilin nuk e ka kërkuar personi i dënuar, drejtori i</p>	<p>one unit of the correctional institution to the other, if that is necessary:</p> <p>1.1.for implementing his correctional and resocialization program or work program;</p> <p>1.2.for encouraging the contacts between the convicted person and his family and social circle, in order to facilitate his eventual reintegration in the community;</p> <p>1.3.for the protection and safety of the convicted person;</p> <p>1.4.for the interest of maintaining order and discipline within the correctional institution;</p> <p>1.5.due to health treatment.</p> <p>2.The decision for the transfer of the convicted person shall be issued by the general director of the correctional service upon the proposal of the director of the correctional institution, or upon the request of the convicted person or any other immediate family member.</p> <p>3.In case of a transfer that was not requested by the convicted person, the director of the</p>	<p>iz jedne jedinice kazneno popravne ustanove u drugu ako je to potrebno:</p> <p>1.1.za sprovođenje programa njegove resocijalizacije ili programa rada.</p> <p>1.2.da se podstaknu kontakti između osuđenog lica i njegove porodice i društvenog kruga u cilju pospešivanja njegove konačne reintegracije u društvo;</p> <p>1.3.radi zaštite i bezbednosti osuđenog lica;</p> <p>1.4.u interesu očuvanja reda i discipline u kazneno popravnoj ustanovi; ili</p> <p>1.5.zbog zdravstvenog tretmana.</p> <p>2.Odluku o premeštaju osuđenog lica donosi generalni direktor Kazneno popravne službe na predlog Direktora kazneno popravne ustanove ili na zahtev osuđenog lica ili člana uže porodice.</p> <p>3.U slučaju premeštaja koje osuđeno lice nije tražilo, direktor kazneno popravne ustanove</p>
--	--	--

<p>institucionit korrektues siguron që personi i dënuar të njoftohet lidhur me arsyet për transferim brenda njëzetekatër (24) orëve nga marrja e vendimit, si dhe para ekzekutimit të tij.</p> <p>4. Bashkëshortja e personit të dënuar, anëtari i familjes ose ndonjë person tjetër i caktuar nga personi i dënuar duhet të njoftohen lidhur me transferimin brenda njëzetekatër (24) orëve nga marrja e vendimit.</p> <p>5. I burgosuri nuk mund të parashtrojë kërkesë të sërishme për transferimin, derisa të kalojnë gjashtë (6) muaj nga paraqitja e kërkesës së tij të fundit për transferim.</p> <p>6. Përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, personi i dënuar mund të transferohet prej një institucioni korrektues të tipit të mbyllur në një institucion të tipit të hapur, nëse:</p> <p>6.1. I burgosuri përshtatet me aktivitetet e përgatitura në institucionin e hapur apo me aktivitetet e tjera të miratuara nga institucioni i hapur;</p> <p>6.2. Mund të besohet se i burgosuri do të respektojë rendin e institucionit të hapur, nuk do të kryejë ndonjë vepër dhe nuk do të dalë prej</p>	<p>correctional institution shall ensure that the convicted person is notified about the reasons of transfer within twenty four (24) hours from the receipt of the decision and before its execution.</p> <p>4. The spouse of the convicted person, family member of another person appointed by the convicted person shall be notified about the transfer within twenty four (24) hours from the receipt of the decision.</p> <p>5. The convicted person may again submit a request for transfer, six (6) months after the submission of his last request for transfer.</p> <p>6. In addition to requirements set forth in paragraph 1 of this article, the convicted person may be transferred from a correctional institution of the closed type to an institution of open type, if:</p> <p>6.1. the convicted person is adapted to the activities prepared in the open institution or other activities approved by the open institution;</p> <p>6.2. it is believed that the convicted person shall comply with the order of the open institution, shall not commit an offence and shall not leave the open</p>	<p>stara se da osuđeno lice bude obavešteno o razlozima za premeštaj u roku od dvadeset i četiri (24) sata od donošenja odluke.</p> <p>4. Bračni drug osuđenog lica, član porodice ili bilo koje drugo lice koje osuđeno lice odredi treba da bude obavešteno o premeštaju u roku od dvadeset i četiri (24) časa, od donošenja odluke.</p> <p>5. Zatvorenik ne može ponovo da podnese zahtev za premeštaj dok ne protekne šest (6) meseci od njegovog poslednjeg zahteva za premeštaj.</p> <p>6. Osim uslova iz stava 1 ovog člana, osuđeno lice može biti premešteno iz Kazneno popravne ustanove zatvorenog tipa u Kazneno popravnu ustanovu otvorenog tipa, ako:</p> <p>6.1. osuđeno lice je prilagođen aktivnostima koje su pripremljene u otvorenoj instituciji ili drugim aktivnostima odobrenim od strane otvorene institucije;</p> <p>6.2. može se verovati da će osuđeni postupati u skladu sa radom otvorene institucije, neće izvršiti krivično delo</p>
---	---	---

<p>institucionit të hapur pa autorizim; dhe nëse</p> <p>6.3. I burgosuri zotohet të përmbahet nga përdorimi i substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe t'i nënshtrohet kontrollit të përmbajtjes nga intoksikimi nga këto substanca.</p> <p>7. Përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, personi i dënuar mund të transferohet prej një institucioni korrektues të tipit të hapur në një institucion të tipit të mbyllur, nëse:</p> <p>7.1. I burgosuri nuk i përmbahet kushteve të përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni;</p> <p>7.2. I burgosuri refuzon të marr pjesë në aktivitete të përgatitura në përputhje me planin për kohëzgjatjen e dënimit, ose nuk përshtatet me aktivitetet e përgatitura në institucionin e hapur apo të miratuara nga institucioni i hapur;</p> <p>7.3. I burgosuri refuzon t'i nënshtrohet kontrollës së përmbajtjes nga substancat intoksikuese;</p> <p>7.4. Pritet shqiptimi i ndonjë dënimi të ri me burgim apo gjobë e</p>	<p>institution without authorization; and if</p> <p>6.3. the convicted person is committed to refraining from the use of narcotic and psychotropic substances to undergoing the test of the content of intoxicating substances.</p> <p>7. In addition to the requirements set forth in paragraph 1 of this article, the convicted person may be transferred from a correctional institution of open type to an institution of closed type, if:</p> <p>7.1. the convicted person does not comply with the requirements set forth in paragraph 6 of this article.</p> <p>7.2. the convicted person refuses to participate in activities prepared in accordance with the plan for the duration of imprisonment, or does not adapt to the activities prepared in the open institution or approved by the open institution;</p> <p>7.3. the convicted person refuses to undergo the test of the content of intoxicating substances.</p> <p>7.4.a new punishment by imprisonment or by fine replacing the</p>	<p>i nëçe izlaziti iz otvorene institucije bez dozvole; i ako</p> <p>6.3. osuđeni je obećao da će se uzdržati od upotrebe narkotičkih i psihotropnih supstanci za ispitivanje sadržaja opojnih supstanci.</p> <p>7. Pored uslova iz stava 1 ovog člana osuđeno lice može biti prebačeno iz Kazneno popravne ustanove otvorenog tipa u Kazneno popravnu ustanovu zatvorenog tipa ako:</p> <p>7.1. osuđeno lice se ne pridržava uslova iz stava 6. ovog člana.</p> <p>7.2. osuđeno lice odbija da učestvuje u aktivnostima koje su pripremljene u skladu sa planom za vreme trajanja kazne zatvora ili se ne prilagođava aktivnostima koje su pripremljene u otvorenoj instituciji ili koje odobrava otvorena institucija;</p> <p>7.3. osuđeno lice odbija da se podvrgne testu sadržaja opojnih supstanci.</p> <p>7.4. očekuje se nova kazna zatvora ili novčana kazna zatvora i ne</p>
--	---	--

<p>2.2.Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të të miturve dhe masave edukuese, përveç nëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur e parasheh ndryshe;</p> <p>2.3.Organizimin e programeve që i kontribuojnë korrektimit, përgatitjes për lirim dhe mbikëqyrjes afatgjatë të personave të dënuar me burgim dhe me burgim të përjetëshëm;</p> <p>2.4.Vleresimin e rrezikut kriminogjen dhe për caktimin e nevojave për trajtim të kryerësve të veprave penale;</p> <p>2.5.Me qëllim të eliminimit të shkaqeve të korrupsionit në Shërbimin Korrektues, institucionet korrektuese në pajtim me këtë Ligj, aktet nënligjore përkatëse, të cilat do të nxjerrën për zbatimin e këtij ligji, duhet të vendosin dispozitat antikorruptive në veçanti për promovimin dhe ekzistimin e sistemit të qartë për shpërblime dhe sanksione në pjesën e zbatimit të programit të veprimit;</p>	<p>2.2. Organizing, implementing and supervising the imprisonment of minors and educational measures, unless the Code of Justice for Minors provides otherwise;</p> <p>2.3. Organizing programs that contribute to the correction, preparing the release and long-term supervising of persons convicted with imprisonment and life imprisonment;</p> <p>2.4. Criminal risk assessment and setting the needs for the treatment of perpetrators of criminal offences;</p> <p>2.5.In order to eliminate the causes of corruption in the Correctional Service, the correctional institution, in accordance with the Law and respectively bylaws that adopted for the implementation of this law, shall apply anticorruption provisions particularly for the promotion and functioning of a clear system for rewards and sanctions, as part of the implementation of action program;</p>	<p>2.2. Organizovanje, sprovođenje i nadgledanje kazne zatvora maloletnika i obrazovnih mera, osim ako Kodeks pravde za maloletnike ne propisuje drugačije;</p> <p>2.3. Organizovanje programa koji doprinose popravci, priprema puštanja i dugotrajnog nadzora nad osobama osuđenim kaznom zatvora i doživotnom zatvorom;</p> <p>2.4. Procena kriminalnog rizika i utvrđivanje potreba za tretman počinitelaca krivičnih djela;</p> <p>2.5. U cilju otklanjanja uzroka korupcije u Kazneno-popravnoj službi, kazneno-popravna ustanova, u skladu sa Zakonom i podzakonskim aktima koji su usvojeni za primenu ovog zakona, primenjuje odredbe protiv korupcije posebno za promociju i funkcionisanje jasnog sistema za nagrade i sankcije, kao deo implementacije akcionog programa;</p>
---	---	---

<p>2.6. Zhvillimin e standardeve të etikës;</p> <p>2.7.Për realizimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse, shoqatat dhe organizatat të cilat merren me problemet e ekzekutimit të sanksioneve penale.</p> <p>3.Shërbimi korrektues ka statusin e personit juridik.</p> <p>4. Shërbimi Korrektues ka logon, stemën dhe vulën e vet identifikuese dhe ka selinë në Prishtinë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 191 Struktura organizative e Shërbimit Korrektues</p> <p>1.Për kryerjen e punëve dhe detyrave nga kompetenca e Shërbimit Korrektues themelohen këto njësi themelore organizative:</p> <p>1.1.Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues me seli në Prishtinë; dhe</p> <p>1.2.Institucionet korrektuese.</p>	<p>2.6. Development of standards of ethics;</p> <p>2.7. For establishing cooperation with respective institutions, associations and organizations dealing with the problems of execution of criminal sanctions.</p> <p>3. Correctional service has the status of legal person.</p> <p>4. Correctional service has its logo, emblem and identification seal and its seat is in Prishtina.</p> <p style="text-align: center;">Article 191 Organizational structure of the Correctional Service</p> <p>1. The following basic organizational units shall be established for the performance of tasks and duties by the Correctional Service:</p> <p>1.1.General Directorate of Correctional Service with seat in Prishtina; and</p> <p>1.2.Correctional institutions.</p>	<p>2.6. Razvoj standarda etike;</p> <p>2.7. Za uspostavljanje saradnje sa odgovarajućim institucijama, udruženjima i organizacijama koje se bave problemima izvršenja krivičnih sankcija.</p> <p>3. Kazнено-popravna služba ima status pravnog lica.</p> <p>4. Kazнено-popravna služba ima svoj logo, amblem i pečat za identifikaciju, a sedište joj je u Prištini.</p> <p style="text-align: center;">Član 191 Organizaciona struktura Kazнено popravne Službe</p> <p>1.Za obavljanje posla i zadataka iz nadležnosti Kazнено popravne službe osnovane su osnovne organizacione jedinice kao što sledi:</p> <p>1.1.Generalna Direkcija Kazнено popravne službe sa sedištem u Prištini, i</p> <p>1.2.Kazнено popravne ustanove.</p>
---	--	--

<p>2.Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në Shërbimin Korrektues dhe i institucioneve korrektuese rregullohet me akt të veçantë, të cilin e miraton Ministri, dhe që përfshihet si kre i veçantë në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 192 Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Korrektues</p> <p>1.Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues, e mbikëqyrë dhe e siguron zbatimin e ligjshmërinë së punës dhe të veprimit të njësive organizative të Shërbimit Korrektues dhe të institucioneve korrektuese.</p> <p>2.Në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues themelohen drejtoritë dhe sektorët. Me drejtorinë udhëheqin, udhëheqësit të cilët emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>3.Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues njëherit është edhe udhëheqës i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Korrektues.</p>	<p>2.The internal organization and organizational chart of the Correctional Service and correctional institution shall be governed by a separate act, approved by the Minister, which shall be included as a separate act in the Rules of Procedure of the Ministry on internal organization and organizational chart.</p> <p style="text-align: center;">Article 192 Responsibilities of the General Directorate of Correctional Service</p> <p>1.The General Directorate of Correctional Service shall supervise and ensure the implementation of the legality of work and actions of the organizational units of the Correctional Service and correctional institutions.</p> <p>2.Directorates and sectors shall be established in the General Directorate of the Correctional Service. The directorate shall be managed by the managers appointed by the General Director of the Correctional Service, in accordance with applicable legislation.</p> <p>3.The General Director of the Correctional Service is also the manager of the General Directorate of the Correctional Service.</p>	<p>2.Unutrašnja organizacija i sistematizacija radnih mesta u Kazneno popravnoj službi i Kazneno popravnim ustanovima regulisana je posebnim aktom, koji usvaja Ministar, a koji je uključen kao poseban dio Uredbe o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta Ministarstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 192 Odgovornosti Generalne Direkcije Kazneno popravne službe</p> <p>1.Generalna Direkcija Kazneno popravne službe, koja nadgleda i obezbeđuje sprovođenje zakonitosti rada i funkcionisanja organizacionih jedinica Kazneno popravne službe i Kazneno popravnih ustanovima.</p> <p>2.U Generalnoj Direkciji Kazneno popravne službe osnovane su direkcije i sektori. Direkcije rukovode, rukovodioci koe imenuje Generalni Direktor Kazneno popravne službe, u skladu sa određenim važećim zakonima koji su na snazi.</p> <p>3.Generalni Direktor Kazneno popravne službe istovremeno je i vođa Generalne Direkcije Kazneno popravne službe.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 193 Llojet e institucioneve korrektuese</p>	<p style="text-align: center;">Article 193 Types of correctional institutions</p>	<p style="text-align: center;">Član 193 Vrste Kazneno popravnih ustanovima</p>
<p>1.Në Shërbimin Korrektues ekzistojnë këto lloje të institucioneve korrektuese:</p> <p>1.1.Burgjet, për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm;</p> <p>1.2.Qendrat e paraburgimit, për ekzekutimin e paraburgimit dhe dënimeve me burgim deri në tre (3) muaj;</p> <p>1.3.Burgjet për femra, për ekzekutimin e dënimit me burgim, burgimit për të mitur të shqiptuar ndaj femrave;</p> <p>1.4.Qendra korrektuese për të mitur, për ekzekutimin e burgimit të të miturve;</p> <p>1.5.Institucionet edukative-korrektuese, për ekzekutimin e masave edukative të dërgimit të kryerësit të mitur në institucionin edukativo-korrektues;</p>	<p>1.The Correctional Service shall have following types of the correctional institutions:</p> <p>1.1.prisons, for the execution of imprisonment and life imprisonment;</p> <p>1.2.detention centers, for the execution of detention and imprisonment up to three (3) months;</p> <p>1.3.prisons for females, for the execution of imprisonment, juvenile imprisonment imposed on females;</p> <p>1.4.juvenile correctional center, for the execution of juvenile imprisonment;</p> <p>1.5.educational-correctional institution, for the execution of education measures for sending the juvenile offender to the educational-correctional institution;</p>	<p>1.U Kazneno popravnoj službi postoje ove vrste Kazneno popravnih ustanovima:</p> <p>1.1.zatvori, za izvršenje zatvorske kazne i doživotne zatvorske kazne;</p> <p>1.2.centar za pritvor, za izvršenje kazni pritvora i zatvorske kazne do tri (3) meseci;</p> <p>1.3.ženski zatvor, za izvršenje zatvorske kazne, i zatvorske kazne maloletnika koje su izrečene ženskom polu;</p> <p>1.4.kazneno popravni centar za maloletnike, za izvršenje zatvorske kazne maloletnika;</p> <p>1.5.vaspitno-popravne Kazneno popravne ustanove, za izvršenje vaspitno-popravne mere slanja maloletnih počinioca u vaspitno-popravnoj instituciji;</p>

<p>1.6.Spitali dhe ambulancat e burgjeve, për trajtimin e personave të paraburgosur dhe personave të dënuar.</p> <p>1.7.Institucionet shëndetësore të përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi për Trajtimin e Personave të Paraburgosur dhe Personave të Dënuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 194 Tipet e Institucioneve Korrektuese</p> <p>1.Në bazë të shkallës së sigurisë dhe mënyrës së trajtimit të personave të dënuar, institucionet korrektuese mund të jenë të tipit të mbyllur, gjysmë të hapur dhe të hapur.</p> <p>2.Institucionet korrektuese të tipit të mbyllur kanë elemente të sigurisë fizike dhe materiale, siç janë zyrtaret korrektues të armatosur, muret rrethuese apo rrethoja, pajimet teknike dhe masat tjera të sigurisë që pengojnë arratisjen e personave të dënuar. Në kuadër të tipit të mbyllur bënë pjesë edhe Burgu i Sigurisë së Lartë, për ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj personave të klasifikuar me rrezikshmëri shumë të lartë, personave të paraburgosur të klasifikuar me rrezikshmëri shumë të lartë dhe atyre të dënuar me burgim të përjetshëm.</p>	<p>1.6.prison hospitals and clinics, for the treatment of detainees and convicted persons.</p> <p>1.7.health institutions provided in the Law on Health for the treatment of detainees and convicted persons.</p> <p style="text-align: center;">Article 194 Categories of Correctional Institutions</p> <p>1.Based on the level of security and manner of treatment of convicted persons, the correctional institution may be closed, semi-open and open.</p> <p>2.Closed correctional institutions have elements of physical and material security, such as armed correction officers, encircling walls or fence, technical equipment and other security measures that prevent the escape of convicted persons. Closed correctional institution include the high security prison for the execution of imprisonment of persons categorized with high risk, detainees categorized with high risk and those serving life imprisonment.</p>	<p>1.6.zatvorske bolnice i ambulante, za tretman osoba u pritvoru i kažnjenih osoba.</p> <p>1.7.zdravstvene institucije određene Zakonom za Zdravstvo i tretman lica u pritvoru i kažnjenih lica.</p> <p style="text-align: center;">Član 194 Vrste Kazneno popravnih ustanovima</p> <p>1.Na osnovu stepena bezbednosti i načina tretmana osuđenih lica, kazneno popravnne ustanove mogu biti zatvorenog, polu otvorenog ili otvorenog tipa.</p> <p>2.Kazneno popravnne ustanove zatvorenog tipa imaju fizičke i materijalne bezbednosne elemente, kao što su naoružani korektivni službenici, zidana ograda ili obična ograda, tehnički uređaji i druge bezbedonosne mere koje sprečavaju bekstvo osuđenih lica. U okviru zatvorenog tipa spada i zatvor stepena visoke bezbednosti, za izvršenje zatvorske kazne lica koji su klasifikovani kao velika opasnost, lica u pritvoru koji su klasifikovani kao velika opasnost i onih koji su osuđeni doživotnim zatvorom.</p>
--	---	--

<p>3.Institucionet korrektuese të tipit gjysmë të hapur nuk kanë elemente të sigurisë fizike në formë të mbikëqyrjes së lëvizjeve dhe punës së personit të dënuar, por kanë elemente të sigurisë materiale që e pengojnë arratisjen e personave të dënuar.</p> <p>4.Institucionet korrektuese të tipit të hapur nuk kanë elemente të sigurisë fizike as materiale që e pengojnë arratisjen e personave të dënuar. Sjellja ndaj personave të dënuar bazohet në vetë disiplinën e tyre dhe përgjegjësinë personale, kurse personeli korrektues mbikëqyrë lëvizjen dhe punën e personave të dënuar.</p> <p>5.Me akt nënligjor, të cilin e nxjerr Ministri, përcaktohen kushtet dhe kriteret për kategorizimin e të burgosurve, si dhe mjete dhe pajisjet e zyrtareve korrektues për secilin tip.</p> <p style="text-align: center;">Neni 195 Njësitë korrektuese</p> <p>Në kuadër të institucionit korrektues mund të ketë njësi të hapur, gjysmë të hapur dhe të mbyllur.</p>	<p>3.Semi-open correctional institutions do not have elements of physical security in the form of monitoring of movements and work of the convicted person, but have elements of material security that would prevent the escape of convicted persons.</p> <p>4. Open correctional institutions do not have elements of physical or material security that would prevent the escape of convicted persons. The conduct toward the convicted persons is based on their discipline and their personal responsibility, whereas the correctional personal monitors the movement and work of convicted persons.</p> <p>5.A bylaw adopted by the Minister shall set forth the terms and conditions for categorization of convicted persons as well as means and equipment of correction officer for each category.</p> <p style="text-align: center;">Article 195 The correctional institution</p> <p>Under the correctional institution there may be an open, semi-open and closed unit.</p>	<p>3.Kazneno popravne ustanove polu otvorenog tipa nemaju fizičke bezbedonosne elemente u obliku nadzora kretanja i rada osuđenih lica, ali imaju materijalno bezbedonosne elemente koje onemogućavaju bekstvo osuđenih lica.</p> <p>4.Kazneno popravne ustanove otvorenog tipa nemaju ni fizičke ni materijalne elemente bezbednosti koje onemogućavaju bekstvo osuđenih lica. Ophođenje prema osuđenim licima se zasniva na njihovoj disciplini i njihovoj ličnoj odgovornosti, dok korektivno osoblje nadzire kretanje i rad osuđenih lica.</p> <p>5.Podzakonskim aktom koji donosi Ministar određuju se uslovi i kriteriji o kategorizaciji zatvorenika kao i predmetima i opreme korektivnih službenika za svaki tip ponaosob.</p> <p style="text-align: center;">Član 195 Korektivne jedinice</p> <p>U okviru Kazneno popravne ustanove može imati otvorene, polu otvorene i zatvorene jedinice.</p>
---	--	--

<p align="center">Neni 196 Institucioneve Korrektuese</p>	<p align="center">Article 196 Correctional Institutions</p>	<p align="center">Član 196 Kazneno popravne ustanove</p>
<p>1.Institucionet korrektuese në Republikën e Kosovës janë, si në vijim:</p> <p>1.1.Qendra Korrektuese Dubravë-institucion korrektues i tipit të mbyllur;</p> <p>1.2.Qendra Korrektuese Lipjan-institucion korrektues i tipit gjysmë të hapur;</p> <p>1.3.Qendra korrektuese Smrekovicë-institucion korrektues i tipit të hapur;</p> <p>1.4.Burgu i Sigurisë së Lartë – institucion Korrektues i tipit të mbyllur me siguri fizike dhe teknike në maksimum.</p> <p>1.5.Qendra e Paraburgimit Lipjan-institucion korrektues i tipit të mbyllur gjysmë të hapur;</p> <p>1.6.Qendra e Paraburgimit Prishtinë-institucion korrektues i tipit të mbyllur;</p>	<p>1.The correctional institutions in the Republic of Kosovo are:</p> <p>1.1.Correctional Center Dubravë-correctional institution of closed category;</p> <p>1.2.Correctional Center Lipjan-correctional institution of semi-open category;</p> <p>1.3.Correctional center Smrekovicë-correctional institution of open category;</p> <p>1.4.High Security Prison – correctional institution of closed category with maximum physical and technical security.</p> <p>1.5.Detention Center Lipjan-correctional institution of closed category;</p> <p>1.6.Detention Center Prishtinë-correctional institution of closed category;</p>	<p>1.Kazneno popravne ustanove u Republiku Kosova su kao što sledi:</p> <p>1.1.Kazneno popravni centar Dubrava-Kazneno popravna ustanova zatvorenog tipa;</p> <p>1.2.Kazneno popravni centar Lipjane-Kazneno popravna ustanova polu zatvorenog tipa;</p> <p>1.3.Kazneno popravni centar Smrekovnica-Kazneno popravna ustanova otvorenog tipa;</p> <p>1.4.Zatvor Visoke Bezbednosti-Kazneno popravna ustanova zatvorenog tipa sa maksimalnom fizičkom i tehničkom bezbednošću.</p> <p>1.5.Pritvorni Centar Lipjane-Kazneno popravna ustanova zatvorenog tipa;</p> <p>1.6.Pritvorni Centar Priština-Kazneno popravna ustanova zatvorenog tipa;</p>

<p>1.7.Qendra e Paraburgimit Prizren-institucion korrektues i tipit të mbyllur;</p> <p>1.8.Qendra e Paraburgimit Gjilan / Novobërdë- institucion korrektues i tipit të mbyllur;</p> <p>1.9.Qendra e Paraburgimit Pejë-institucion korrektues i tipit të mbyllur;</p> <p>1.10.Qendra e Paraburgimit Mitrovicë-institucion korrektues i tipit të mbyllur;</p> <p>1.11. Qendra edukativo korrektuese ne Lipjan-institucion i tipit të hapur dhe gjysme të hapur.</p> <p>2 Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, me propozimin e Ministrit institucionet korrektuese themelohen mbyllën apo riklasifikohen me akt nënligjor të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me këtë akt nënligjor përcaktohet lloji, tipi dhe selia e institucionit korrektues.</p>	<p>1.7.Detention Center Prizren-correctional institution of closed category;</p> <p>1.8.Detention Center Gjilan / Novobërd- correctional institution of closed category;</p> <p>1.9.Detention Center Pejë-correctional institution of closed category;</p> <p>1.10.Detention Center Mitrovicë-correctional institution of closed category.</p> <p>1:11. Lipjan Educational-Correctional Center – an open and semi-open type institution.</p> <p>2. Exceptionally from paragraph 1 of this article, upon the proposal of the Minister the correctional institution shall be established, closed or reclassified by a bylaw of the Government of the Republic of Kosovo. This bylaw shall set forth the type, category and seat of the correctional institution.</p>	<p>1.7.Pritvorni Centar Prizren-Kazneno popravna ustanova zatvorenog tipa;</p> <p>1.8.Pritvorni Centar Gnjilane / Novo Brdo-Kazneno popravna ustanova zatvorenog tipa;</p> <p>1.9.Pritvorni Centar Peć-Kazneno popravna ustanova zatvorenog tipa;</p> <p>1.10.Pritvorni Centar Mitrovica-Kazneno popravna ustanova zatvorenog tipa.</p> <p>1:11. Obrazovni korektivni centar u Lipljanu-ustanova otvorenog i polu-otvorenog tipa.</p> <p>2. Izuzetak iz stava 1 ovog člana, na predlog Ministra sa podzakonskim aktom, osnivaju se, zatvaraju ili se rekvalifikuju Kazneno popravne ustanove Vlade Republike Kosova. Ovim podzakonskim aktom određuje se vrsta, tip i sedište Kazneno popravne ustanove.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 197 Njësia Ekonomike</p> <p>1.Në kuadër të Shërbimit Korrektues themelohet njësia ekonomike e cila mund të ketë njësitë e saj nëpër institucionet korrektuese.</p> <p>2.Njësia ekonomike themelohet nga Qeveria, me rekomandim të Ministrit të Drejtësisë, me të cilin përcaktohet statusi i njësisë, e cila funksionon në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe krijon të hyra të dedikuara për nevoja të Shërbimit Korrektues.</p> <p>3.Mjetet fillestare të nevojshme për themelimin e njësisë ekonomike sigurohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.</p> <p>4.Me punën e njësisë ekonomike udhëheqë drejtori i njësisë ekonomike, i cili i përgjigjet Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues.</p>	<p style="text-align: center;">Article 197 Economic unit</p> <p>1.Under the correctional service will be established the economic unit which may have its units in the correctional institutions.</p> <p>2.The economic unit shall be established by the Government, upon the recommendation of the Minister of Justice, defining the status of the unit which will operate in compliance with the respective applicable legislation, and generate income for the needs of the Correctional Service.</p> <p>3.The initial required funds for establishing the economic unit shall be provided by the Budget of the Republic of Kosovo.</p> <p>4.The work of the economic unit shall be managed by the director of the economic unit, who reports to the General Director of the Correctional Service.</p>	<p style="text-align: center;">Član 197 Privredna Jedinica</p> <p>1.U okviru Kazneno popravne službe osniva se privredna jedinica koja može imati svoje jedinice u Kazneno popravnim ustanovima.</p> <p>2.Privrednu jedinicu osniva Vlada, na preporuku Ministra Pravde, kojom se određuje status jedinice koja funkcioniše u skladu sa određenim važećim zakonodavstvom koji je na snazi, i stvara prihode koji su namenjeni za potrebe Kazneno popravne službe.</p> <p>3.Početna potrebna sredstva za osnivanje privredne jedinice obezbeđuju se iz Budžeta Republike Kosova.</p> <p>4.Radom privredne jedinice rukovodi direktor privredne jedinice, koji obaveštava Generalnog Direktora Korektivna Službe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 198 Njësia për vlerësim dhe klasifikim</p> <p>Njësia për vlerësim dhe klasifikim të të burgosurve, funksionon në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë përcaktohen me</p>	<p style="text-align: center;">Article 198 Assessment and classification unit</p> <p>The unit for the assessment and classification of the convicted persons shall operate under the Correctional Service of Kosovo. The duties and responsibilities of the unit shall be</p>	<p style="text-align: center;">Član 198 Jedinica za procenu i klasifikaciju</p> <p>Jedinica za procenu i klasifikaciju zatvorenika, funkcioniše u okviru Kazneno popravne službe Kosova. Zadatak i odgovornost jedinice određuju se</p>

<p>aktin nënligjor të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 199 Njësia për mbledhje klasifikim dhe vlerësim të informacioneve</p> <p>Njësia për mbledhje, klasifikimin dhe vlerësimin të informacioneve, funksionon në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë përcaktohen me aktin nënligjor të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 200 Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues</p> <p>1.Me Shërbimin Korrektues udhëheq Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues (më tej: Drejtori i Përgjithshëm).</p> <p>2.Drejtori i Përgjithshëm emërohet në bazë të konkursit të shpallur nga Ministria e Administratës Publike, me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë, në pajtim me dipozitat për Shërbimin Civil për emërimin, për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Komisioni profesional vlerësues duhet të përbëhet nga profesionist përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësues nga shoqëria civile,</p>	<p>specified in the bylaw adopted by the Minister of Justice.</p> <p style="text-align: center;">Article 199 Unit for collection, classification and assessment of information</p> <p>The unit for collection, classification and assessment of information shall operate under the Correctional Service of Kosovo. The duties and responsibilities of the unit shall be specified in the bylaw adopted by the Minister of Justice.</p> <p style="text-align: center;">Article 200 General Director of the Correctional Service</p> <p>1. The Correctional Service shall be managed by the Director of the Correctional Service (hereinafter: General Director).</p> <p>2.The General Director shall be appointed through a vacancy announced by the Ministry of Public Administration, upon the request of the Minister of Justice, in accordance with the provisions of the Civil Service for appointment, senior management positions in the Civil Service of the Republic of Kosovo. The professional evaluation committee shall consist of professional representatives of the Ministry of Justice, representatives from civil</p>	<p>podzakonskim aktom koji usvaja Ministar Pravde.</p> <p style="text-align: center;">Član 199 Jedinica za prikupljanje, klasifikaciju i procenu informacija</p> <p>Jedinica za prikupljanje, klasifikaciju i procenu informacija, funkcionise u okviru Kazнено popravne službe Kosova. Zadatak i odgovornost jedinice određuju se podzakonskim aktom koji usvaja Ministar Pravde.</p> <p style="text-align: center;">Član 200 Generalni Direktor Kazнено popravne službe</p> <p>1.Kazнено popravnom službom rukovodi Generalni Direktor Kazнено popravne službe (u daljem tekstu: Generalni Direktor).</p> <p>2.Generalni Direktor se imenuje na osnovu objavljenog konkursa od strane Ministarstva Javne Administracije (Uprave), na zahtev Ministra Pravde, u skladu sa odredbama Civilne Službe za imenovanje, za visoke rukovodeće funkcije u Civilnoj Službi Republike Kosova. Profesionalna komisija za procenu se treba formirati od strane stručnjaka, predstavnika Ministarstva Pravde, predstavnika civilnog društva,</p>
---	---	--

<p>gjqtar, prokuror i shtetit dhe profesor i fakultetit të drejtësisë, i drejtimit penalo-juridik.</p> <p>3.Drejtori i Përgjithshëm udhëheqë, drejton dhe kontrollon Shërbimin Korrektues dhe të gjitha çështjet lidhur me Shërbimin Korrektues.</p> <p>4.Drejtori i Përgjithshëm emërohet për periudhë kohore pesë (5) vjeçare, me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.</p> <p>5.Për punën e tij Drejtori i Përgjithshëm i përgjigjet drejtpërdrejtë Ministrit.</p>	<p>society, state prosecutor and professors of the faculty of law, branch of criminal justice.</p> <p>3.The General Director shall manage, run and monitor the Correctional Service and all matters related to the Correctional Service.</p> <p>4.The General Director is appointed for a period of five (5) years, with the possibility of reappointment for one more mandate.</p> <p>5.The General Director shall report directly to the Minister.</p>	<p>sudija, državni tužioc i profesora pravnog fakulteta odseka za krivično-pravo.</p> <p>3.Generalni Direktor rukovodi, upravlja i kontroliše Kazneno popravnu službu i svim stvarima koje su vezane za Kazneno popravnu službu.</p> <p>4.Generalni Direktor se imenuje u mandatu od pet (5) godina, sa mogućnošću ponovnog izbora za još jedan mandat.</p> <p>5.Za svoj rad Generalni Direktor direktno odgovara Ministru.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 201 Kushtet për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm</p>	<p style="text-align: center;">Article 201 Requirements for the appointment of General Director</p>	<p style="text-align: center;">Član 201 Uslovi za imenovanje Generalnog Direktora</p>
<p>1.Detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm mund ta ushtroj kandidati i cili i plotëson kushtet në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 .Të ketë përgatitje universitare;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3.Të ketë tetë (8) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku</p>	<p>1.The duty of the General Director may be exercised by the applicant who fulfills the following requirements:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. is a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 .has a university degree;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3.has eight (8) years of professional experience, of which at least five (5) years of managerial experience;</p>	<p>1.Zadatak Generalnog Direktora može vršiti kandidat koji ispunjava sledeće uslove:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. biti državljanin Republike Kosova;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 .imati fakultetsko (visoko) obrazovanje;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3.imati osam (8) godina iskustva profesionalnog rada, od kojih</p>

<p>pesë (5) vite përvojë pune menaxheriale;</p> <p>1.4.Të mos jetë anëtarë i ndonjë partie politike;</p> <p>1.5.Të ketë reputacion moral dhe profesional;</p> <p>1.6.Të mos jetë i dënuar për vepër penale.</p>	<p>1.4.is not a member of any body of a political party;</p> <p>1.5.has moral and professional reputation;</p> <p>1.6.is not convicted of a criminal offence.</p>	<p>najmanje pet (5) godina iskustva rukovodećeg rada;</p> <p>1.4.da ne bude član nekog organa neke političke stranke;</p> <p>1.5.imati moralnu i profesionalnu reputaciju;</p> <p>1.6.da nije osuđivan za neko krivično delo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 202 Drejtorët dhe zëvendësdejtoret</p> <p>1.Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues, me konkurs në pajtim me kriteret dhe procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi për emërimin në pozita të nivelit drejtues në shërbimin civil në Republikën e Kosovës.</p> <p>2.Shërbimi Korrektues dhe institucionet korrektuese mund të kenë edhe zëvendësdejtoret, të cilët emërohen sipas procedurës dhe kriterëve të parapara për drejtorët e institucioneve korrektuese.</p>	<p style="text-align: center;">Article 202 Directors and deputy directors</p> <p>1.Directors of correctional institutions are appointed by the General Director of the Correctional Service through a vacancy and in accordance with the requirements and procedures provided in the applicable legislation for the appointment of managerial positions in the civil service of the Republic of Kosovo.</p> <p>2.Correctional Service and Correctional institutions may have their deputy directors who are appointed according to the procedures and requirements set forth for the directors of the correctional institutions.</p>	<p style="text-align: center;">Član 202 Direktori i zamenici direktora</p> <p>1.Direktori Kazнено popravnih ustanovima imenuju se od strane Generalnog Direktora Kazнено popravne službe, u skladu sa kriterima i procedurama konkursa predviđeni pravosnažnim zakonodavstvom za imenovanje na nivou visoko rukovodećim položajima civilne službe Republike Kosova.</p> <p>2.Kazнено popravna služba i Kazнено popravne ustanove mogu imati i zamenike direktora koji se imenuju po proceduri predviđenih kriterijumima za direktore Kazнено popravnih ustanovima.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 203 Organizimi i Brendshëm i Institucioneve Korrektuese</p> <p>Në institucionet korrektuese, varësisht nga madhësia dhe nga përmbajtja e punëve të institucionit korrektues mund të themelohen drejtorate dhe sektore. Në kuadër të shërbimeve mund të organizohen edhe sektore, pavijone apo struktura tjera të veçanta. Me aktin nënligjor për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Shërbimit Korrektues, përcaktohet organizimi i brendshëm, pozitat dhe vendet e punës në institucionet korrektuese.</p>	<p style="text-align: center;">Article 203 Internal Organization of Correctional Institutions</p> <p>Depending on the size and content of the works in correctional institution, directorate and sectors may be established in correctional institutions. Under the services there may established sectors, wards or other particular structures. The bylaw on internal organization and appointment of positions in the Correctional Service shall govern the internal organization, the positions and systematization of workplaces in the correctional institutions.</p>	<p style="text-align: center;">Član 203 Unutrašnja organizacija Kazneno popravnih ustanovima</p> <p>U Kazneno popravnim ustanovima, zavisno od veličine i sadržaja poslova Kazneno popravne ustanove mogu se osnovati direkcije i sektori. U okviru usluga mogu se organizovati i sektori, paviljoni ili ostale posebne strukture. Podzakonskim aktom za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta Kazneno popravne službe određuje se unutrašnja organizacija, radna mesta i položaji u Kazneno popravnju ustanovu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 204 Personeli i Shërbimit Korrektues</p> <p>1. Personelin e Shërbimit Korrektues dhe të institucioneve korrektuese e përbëjnë nëpunësit civil në pajtim me dispozitat për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe zyrtarët korrektues të shërbimit Korrektues dhe të institucioneve korrektuese në pajtim me këtë ligj.</p> <p>2. Me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri përcaktohen gradat e zyrtarëve korrektues, kontrollimi i së kaluarës së tyre, periudha provuese dhe promovimi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 204 Correctional Service Personnel</p> <p>1. The personnel of Correctional Service and correctional institutions consists of civil servants in accordance with the provisions on civil service in the Republic of Kosovo and correction officers of correctional service and correctional institutions in accordance with the law.</p> <p>2. The bylaw adopt by the Minister shall govern the ranks of the correction officers, their background check, probation period and promotion.</p>	<p style="text-align: center;">Član 204 Osoblje Kazneno popravne službe</p> <p>1. Osoblje Kazneno popravne službe i Kazneno popravnih ustanovima formirano je od civilnih zaposlenika u skladu sa odredbama civilne službe Republike Kosova i korektivnih službenika Kazneno popravne službe i Kazneno popravnih ustanovima shodno ovim zakonom.</p> <p>2. Podzakonskim aktom koji donosi Ministar određuju se činovi korektivnih službenika, kontrola njihove prošlosti, probni period i promociju.</p>

<p>2.1.me akt nënligjor që e nxjerr Qeveria rregullohen beneficionet tjera te parapara me legjislacionin përkatës ne fuqi.</p> <p>3.Shërbimi Korrektues e harton, ndërsa Ministri miraton Kodin e Etikës Profesionale për zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues.</p> <p style="text-align: center;">Neni 205 Zyrtarët korrektues</p> <p>1.Zyrtarët korrektues i emëron dhe shkarkon nga Drejtori i Përgjithshëm në bazë të Ligjit të Punës.</p> <p>2.Në Shërbimin Korrektues si zyrtar korrektues mund të pranohet personi, i cili i plotëson:</p> <p>2.1.Kushtet e përgjithshme të parapara për zyrtaret korrektues sipas ligjit të punës;</p> <p>2.2.Kushtet e veçanta në pikëpamje të kualifikimit përkatës shkollor dhe profesional, të përvojës së punës, dhe të kushteve tjera të përcaktuara me aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria e të propozuar nga Ministria e Drejtësisë.</p>	<p>2.1.A sub-legal act issued by the Government regulates other benefits provided for by the relevant legislation in force.</p> <p>3.Correctional Service shall draft and the Minister shall adopt the Code of Professional Ethics for the correction officers of the Correctional Service.</p> <p style="text-align: center;">Article 205 Correction officers</p> <p>1.The correction officers are appointed and dismissed by the General Director in accordance with the Labor Law.</p> <p>2.A correction officer in the correctional service may be the person who meets:</p> <p>2.1.the general conditions for correction officers specified under the labor law;</p> <p>2.2.special conditions in terms of adequate educational and professional qualification, work experience, and other conditions provided in the bylaw adopted by the Government and proposed by the Ministry of Justice.</p>	<p>2.1. Podzakonski akt izdat od strane Vlade reguliše druge beneficije predviđene odgovarajućim zakonodavstvom na snazi.</p> <p>3.Kazneno popravna služba radi nacrt, dok Ministar usvaja Kodeks Profesionalne Etike za kazneno popravne službenike Kazneno popravne službe.</p> <p style="text-align: center;">Član 205 Korektivni Službenik</p> <p>1.Kazneno popravne službenike imenuje i razrešava dužnosti Generalni Direktor na osnovu Zakona o Radu.</p> <p>2.U Kazneno popravnoj službi kao korektivni službenici mogu biti primljena lica koja ispunjavaju sledeće:</p> <p>2.1.opšte uslove predviđeni za kazneno popravne službenike prema zakona o radu;</p> <p>2.2.posebne uslove u pogledu odgovarajuće školske i profesionalne kvalifikacije, iskustva rada, i ostalim uslovima određenim podzakonskim aktom usvojen od Vlade, koji je predložen od Ministra Pravde.</p>
---	---	---

<p>3. Personat të cilët themelojnë marrëdhënie pune si zyrtar korrektues me Shërbimin Korrektues në punët e drejtorateve të sigurimit, në punët e trajtimit si edukues dhe në punët e instruktorit, përpos kushteve të parapara në paragrafin 1. të këtij neni, duhet t'i plotësojnë edhe aftësitë shëndetësore dhe psikofizike të nevojshme për kryerjen e atyre punëve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 206 Llogaritja e përvojës së punës së zyrtarëve korrektues</p> <p>1. Zyrtarët korrektues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet në shtesë e të ardhurave.</p> <p>2. Kategorizimi i zyrtarëve korrektues, të cilët do të realizojnë beneficinet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni rregullohen me akt të veçantë nënligjor të cilin e nxjerr Qeveria me propozim të Ministrisë së Drejtësisë.</p>	<p>3. Persons establishing employment relationship as correction officers with the Correctional Service on security directorates, treatment as educators and as instructors, apart from conditions set out in paragraph 1 of this article, shall possess the required health and psycho-physical abilities and skills for the performance of these jobs.</p> <p style="text-align: center;">Article 206 Calculation of work experience of correctional officers</p> <p>1. Due to hazard, gravity of work and special working conditions, each twelve (12) months of work by correctional officers, shall be calculated as sixteen (16) months of work experience and when calculating their salaries an allowance shall be ensured.</p> <p>2. Categorization of correctional officers, who shall be entitled to benefits provided for in paragraph 1 of this Article, shall be regulated with a special secondary legislation to be issued by the Government with the proposal of the Ministry of Justice.</p>	<p>3. Osobe koje sklope ugovor o radu sa Kazneno popravnom službom kao korektivni službenik na posao direkcija bezbednosti, na poslu tretmana kao vaspitač i na posao instruktora, osim uslova koji su predviđeni stavom 1. ovog zakona, trebaju ispunjavati i zdravstvene i psihofizičke potrebne sposobnosti za obavljanje tih poslova.</p> <p style="text-align: center;">Član 206 Izračun radnog iskustva službenika kazneno popravne ustanove</p> <p>1. Za korektivne službenike, zbog opasnosti, važnosti, kao i drugih posebnih uslova rada, za svakih dvanest (12) meseci rada, računa se kao šesnest (16) meseci obezbeđenog staža, dok se u obračunu plate obezbeđuje jedan dodatak prihoda.</p> <p>2. Kategorizacija korektivnih službenika, koji će realizovati predviđene beneficije predviđene stavom 1 ovog člana reguliše se posebnim podzakonskim aktom kojeg donosi Vlada predlogom Ministarstva pravde.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 207 Puna jashtë orarit</p> <p>Me vendimin e Drejtorit të institucionit korrektues, në interes të shërbimit, sipas nevojës së krijuar, personi i punësuar është i detyruar të punojë edhe më gjatë se koha e punës së plotë, dhe mund t'i ndërpritet apo t'i shtyhet shfrytëzimi i pushimit vjetor.</p>	<p style="text-align: center;">Article 207 Overtime work</p> <p>By the decision of the Director of correctional institution and for the interest of the service, when needed, an employed person shall be obliged to work extra hours and his annual leave may be interrupted or postponed.</p>	<p style="text-align: center;">Član 207 Prekovremeni rad</p> <p>Odlukom Direktora Kazneno popravne ustanove, u interesu usluga, zavisno po potrebi, zaposleno lice je obavezan raditi i prekovremeni rad, i može mu se skratiti ili odložiti korišćenje godišnjeg odmora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 208 Aftësimi Profesional</p> <p>1.Për të punësuarit si zyrtar korrektues në institucionet korrektuese, të cilët punojnë në punët e ekzekutimit të sanksioneve penale, është i detyrueshëm arsimimi dhe aftësimi profesional i vazhdueshëm në pajtim me planin dhe programin e trajnimit të arsimimit dhe aftësimin profesional.</p> <p>2.Për arsimimin dhe aftësimin profesional të punësuarve nga paragrafi 1 i këtij neni, shërbimi korrektues mundet në mënyrë të pavarur, apo nëpërmjet të organizatës profesionale vendore apo të jashtme, me projekte të organizojë seminare, këshillime dhe forma tjera të aftësimin profesional.</p>	<p style="text-align: center;">Article 208 Professional training</p> <p>1. Employees as correctional officers in the correctional institutions, working in the execution of penal sanctions, shall be obliged to have a completed education and permanent vocational training in compliance with the vocational training and education curricula.</p> <p>2. For the vocational training and education of employees set out in paragraph 1 of this article, Correctional Service may independently or through a professional local or international organization organize seminars, counseling and other forms of vocational training.</p>	<p style="text-align: center;">Član 208 Stručno usavršavanje</p> <p>1.Zaposleni kao korektivni službenici u Kazneno popravnim ustanovima koji rade na izvršenju krivičnih sankcija, obavezno je neprekidno profesionalno obrazovanje i sposobnost u skladu sa planom i programom obuke obrazovanja i profesionalnog usavršavanja.</p> <p>2.Za obrazovanje i profesionalno usavršavanje zaposlenih iz stava 1. ovog zakona, kazneno popravna služba može na nezavistan način, ili preko neke domaće ili strane profesionalne organizacije, pomoću projekata organizovati seminare, savetovanja i ostalih vrsta profesionalnog ili stručnog usavršavanja.</p>

<p>3. Planin dhe programin mësimor të arsimimit profesional e nxjerrë Drejtori i Përgjithshëm, pas marrjes së pëlqimit nga Ministri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 209 Vërtetimi i aftësive shëndetësore dhe psikofizike i zyrtarëve korrektues</p> <p>1. Vërtetimi i aftësive shëndetësore dhe psikofizike të punësuarve si zyrtar korrektues, të cilët punojnë në punët e sigurimit kryhet njëherë gjatë dy (2) viteve, ndërsa sipas nevojës së paraparë mund të dërgohen edhe në periudhat më të shkurta kohore, për çka vendosë drejtori i përgjithshëm.</p> <p>2. Vërtetimi i aftësive shëndetësore të punësuarve të cilët punojnë në punët e tjera për të cilat stazhi i punës llogaritet në kohëzgjatje të rritur, kryhet një herë në tre vjet, ndërsa sipas nevojës së paraqitur mund të dërgohen edhe në periudhat kohore më të shkurta, për çka vendosë drejtori i institucionit korrektues.</p> <p>3. Nëse te i punësuar nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni paraqiten ndryshime psikike apo në gjendjen e përgjithshme shëndetësore, e cila e bënë të paaftë për kryerjen e atyre</p>	<p>3. Vocational training and education curricula shall be issued by the General Director upon the approval of the Minister.</p> <p style="text-align: center;">Article 209 Certificate of health and psychophysical abilities of correctional officers</p> <p>1. Confirmation of health and psychophysical abilities of employees as correction officers working in the area of security shall be conducted every two (2) years. However, if necessary the General Director may decide to conduct the confirmation in shorter periods of time.</p> <p>2. Confirmation of health and psychophysical abilities of employees working in other posts, whose work experience is calculated in an increased form, shall be performed every three (3) years. However, if necessary the director of the correctional institution may decide to conduct the confirmation in shorter periods of time.</p> <p>3. If an employee from paragraphs 1 and 2 of this article suffers psychic or general health condition changes, which make the employee incapable of performing his tasks, the</p>	<p>3. Nastavni plan i program profesionalnog obrazovanja donosi Generalni Direktor, nakon saglasnosti od strane Ministra.</p> <p style="text-align: center;">Član 209 Potvrda o zdravstvenoj i psihofizičkoj sposobnosti službenika za kazneno popravne ustanove</p> <p>1. Zdravstvena i psihofizička potvrda sposobnosti zaposleni kao korektivni službenik koji obavljaju posao obezbeđenja vrši se jednom u dve (2) godine, međutim po potrebi mogu se slati i na kraće vremenske periode, o čemu odlučuje generalni direktor.</p> <p>2. Potvrdu zdravstvenih sposobnosti zaposlenih koji obavljaju druge poslove za koje se računa beneficirani staž, obavlja se jednom u tri godine, međutim po potrebi mogu se slati i na kraće vremenske periode, o čemu odlučuje direktor Kazneno popravne ustanove.</p> <p>3. Ako se kod zaposlenih iz stava 1 i 2 ovog člana pojave psihičke promene, ili generalno na zdravstvenom stanju koja ih čini nesposobnim u obavljanju svojih poslova,</p>
--	---	--

<p>punëve, udhëzohet në organin kompetent për vlerësimin e aftësisë punuese në pajtim me ligjin me të cilin përcaktohen të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor.</p> <p>4.Në qoftë se organi kompetent përcakton ekzistimin e aftësisë profesionale të mbetur, i punësuarit sistemohet në punë të tjera në pajtim me mundësitë e Shërbimit Korrektues apo i mundësohet rikualifikimi. Nëse nuk ekziston mundësia e sistemimit në punë tjera të punësuarit i pushon marrëdhënia e punës.</p> <p>5.Vendimin për pushimin e marrëdhënies së punës e nxjerrë Drejtori i Përgjithshëm.</p>	<p>competent body shall be instructed to assess the working ability of the employee in line with the Law setting out entitlements from the pension and disability insurance.</p> <p>4. If the competent body determines the existence of limited professional abilities, the employee shall be assigned to another post within the possibilities of the Correctional Service or shall be subject to re-qualification. If there are no possibilities of assignment to another post, the employment relationship with the employee shall be terminated.</p> <p>5. Decision on the termination of employment relationship shall be made by the General Director.</p>	<p>upućuju se nadležnom organu na procenu njihove radne sposobnosti u skladu sa zakonom kojim su predviđena prava iz penzionog i invalidskog osiguranja.</p> <p>4.Ukoliko nadležni organ odredi pojavu zaostale profesionalne sposobnosti, zaposleni se sistematizuje na drugi posao u skladu sa mogućnostima Kazneno popravne službe, ili mu se omogućuje rekvalifikacija. Ako ne postoji mogućnost sistematizacije na drugo radno mesto prekida mu se radni odnos.</p> <p>5.Odluku o prekidu radnog odnosa donosi Generalni Direktor.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 210 Transferimi i personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës</p>	<p style="text-align: center;">Article 210 Transfer of personnel of Correctional Service of Kosovo</p>	<p style="text-align: center;">Član 210 Transfer osoblja Kazneno popravne službe Kosova</p>
<p>1.Personi i punësuar në Institucionin korrektues nga neni 205 të këtij ligji, për shkak të nevojave të punës apo për shkak të rritjes së vëllimit të punëve, mundet të transferohet përkohësisht pa pëlqimin e tij në Institucionin tjetër korrektues më së gjati gjashtë (6) muaj gjatë dy (2) viteve, ndërsa me pajtimin e tij më së gjati dymbëdhjetë (12) muaj. Vendimin për transferimin e nxjerrë Drejtori i Përgjithshëm, ndaj të cilit nuk lejohet ankesa.</p>	<p>1.Due to work requirements or due to an increase in the volume of work, an employee of the correctional institution in the context of article 205 of the present law may be transferred provisionally without the employee’s consent to another correctional institution for a maximum of six (6) months within a two (2) year period, and with employee’s consent for a maximum of twelve (12) months. The decision on the transfer shall be made by the General Director, against</p>	<p>1.Zapošljeno lice u Kazneno popravnu ustanovu iz člana 205 ovog zakona, iz razloga radne potrebe, ili iz razloga povećanja obima posla, može se privremeno transferisati bez njegove saglasnosti u nekoj drugoj Kazneno popravnu ustanovu najduže šest (6) meseci u roku od dve (2) godine, dok uz njegovu saglasnost najviše dvanest (12) meseci. Odluku za transfer donosi Generalni Direktor, na koju odluku nema pravo žalbe.</p>

<p>2. Personeli i shërbimit korrektues në pajtim me legjislacionin në fuqi mund të transferohet ose sistemohet për periudhë të përhershme nga një institucion në një institucion tjetër korrektues apo brenda përbrenda të të njëjtit institucion në një institucion tjetër korrektues. Vendimin për transferim, e merr Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues duke marrë në konsideratë pëlqimin e zyrtarit dhe udhëheqësit të drejtpërdrejt të tij.</p> <p>3. Për transferimin e nëpunësve civil të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, zbatohen përshtatshmërisht, dispozitat e legjislacionit në fuqi për transferimin e nëpunësve civil.</p> <p style="text-align: center;">Neni 211 Pushimi i marrëdhënies së punës të zyrtarit korrektues</p> <p>1. Zyrtarit korrektues në Shërbimin Korrektues i pushon marrëdhënia e punës:</p> <p style="text-align: center;">1.1. Në rast vdekje;</p>	<p>which there is no right of appeal.</p> <p>2. In accordance with the applicable legislation the personnel of correctional service may be transferred or assigned for a permanent period from one correctional institution to another or within the same institution in another correctional institution. The decision on transfer shall be made by the General Director of the Correctional Service taking into consideration the consent of the officer and his immediate supervisor.</p> <p>3. For the transfer of civil servants employed in the Correctional Service of Kosovo the provisions of the applicable legislation on the transfer of civil servants shall accordingly apply.</p> <p style="text-align: center;">Article 211 Termination of employment of correction officer</p> <p>1. The correction officer shall be terminated his employment with the Correctional Service:</p> <p style="text-align: center;">1.1. in case of death;</p>	<p>2. Osoblje kazneno popravne službe u skladu sa pravosnažnim zakonodavstvom može biti prebačen ili sistematizovan trajno iz jedne u neku drugu Kazneno popravnu ustanovu ili unutar iste institucije u neku drugu Kazneno popravnu ustanovu. Odluku za transfer donosi Generalni Direktor Kazneno popravne službe uzimajući u obzir saglasnost službenika i njegovog direktnog lidera.</p> <p>3. Za transfer civilnih službenika zapošljeni u Kazneno popravnoj službi Kosova, na odgovarajući način se primenjuju odredbe iz prvosnažnog zakonodavstva za transfer civilnih službenika.</p> <p style="text-align: center;">Član 211 Prestanak radnog odnosa korektivnog službenika</p> <p>1. Korektivnom službeniku prekida se radni odnos u Kazneno popravnoj službi:</p> <p style="text-align: center;">1.1. u slučaju smrti;</p>
---	--	--

<p>1.2.Me skadimin e afati, nëse marrëdhënia e punës është themeluar në kohë të caktuar;</p> <p>1.3.Me kërkesë-marrëveshje;</p> <p>1.4.Kur i punësuari e mbushë moshën e pensionimit sipas ligjit;</p> <p>1.5.Në rast të shuarjes apo riorganizimit të institucionit korrektues, apo të shkëputjes të vendit të punës, nëse nuk sistemohet në vend tjetër të punës në afat prej tre muajsh prej momentit kur ka ardhur deri te riorganizimi, apo shkëputja;</p> <p>1.6.Nëse me aktgjykimin e formës së prerë dënohet me dënim me burg më së paku gjashtë (6) muaj;</p> <p>1.7.Nëse refuzon sistemimin apo kur për shkaqe të paarsyeshme nuk ia fillon punës në të cilën është sistemuar;</p> <p>1.8.Në qoftë se me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës ka heshtë, apo ka dhënë shënime jo të sakta, të cilat kanë qenë me rëndësi për themelimin e marrëdhënies së punës.</p>	<p>1.2.with expiry of contract, if the employment was established for definite time;</p> <p>1.3.upon request-agreement;</p> <p>1.4.when the employee reaches the retirement age under the law;</p> <p>1.5.in case of closure or reorganization of the correctional institution, or closing of position, if he is not assigned to another position within three months from the time the reorganization or closure took place;</p> <p>1.6.if by the final judgment he is punished with imprisonment of up to six (6) months;</p> <p>1.7.if he rejects the assignment to another position, or for unjustifiable reasons he does not commence work in the reassigned position;</p> <p>1.8.if upon the establishment of employment he kept silent or provided inaccurate data which are relevant for the establishment of employment.</p>	<p>1.2.istekom roka, ako je radni odnos sklopljen na određeno vreme;</p> <p>1.3.na sporazumno-zahtevu;</p> <p>1.4.kada zaposleni napuni godine za penzionisanje u skladu sa zakonom;</p> <p>1.5.u slučaju zatvaranja ili reorganizacije Kazneno popravne ustanove, ili prekidu radnog odnosa, ako ne bude sistematizovan na neko drugo radno mesto u roku od tri meseci od trenutka kada je došlo do reorganizacije, ili prekida;</p> <p>1.6.ako pravosnažnom presudom bude kažnjen zatvorskom kaznom najmanje šest (6) meseci;</p> <p>1.7.ako odbije sistematizaciju, ili kada iz neopravdanih razloga ne zapošne posao ne mesto gde je prebačen sistematizacijom;</p> <p>1.8.ukoliko tokom sklapanja radnog odnosa je prećutao, ili je dao netačne podatke koje su bile od značaja za sklapanje radnog odnosa.</p>
--	---	--

<p>2.Për pushimin e marrëdhënies së punës, nxjerr vendim Drejtori i Përgjithshëm.</p> <p>3.Kundër vendimin nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 dite. Ankesa i drejtohet Inspektoratit të Punës.</p> <p>4.Për çështje tjera lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi për marrëdhënien e punës.</p>	<p>2.The General Director shall rendered a decision on the termination of employment.</p> <p>3.Against the decision in paragraph 2 of this article, an appeal may be filed within 15 days. The appeal shall be addressed to the labor inspectorate.</p> <p>4.For other matters related to the termination of employment, the respective provisions of the applicable legislation on employment shall accordingly apply.</p>	<p>2.O prestanku radnog odnosa, odluku donosi Generalni Direktor.</p> <p>3.Protiv odluke iz stava 2 ovog člana, može se predati žalba u roku od 15 dana. Žalba se upućuje Inspektorijatu rada.</p> <p>4.O ostalim stvarima vezano za prekid radnog odnosa, na odgovarajući način se primenjuju relevantne odredbe pravosnažnog zakonodavstva o radnom odnosu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 212</p> <p style="text-align: center;">Kompensimi për vdekje në detyrë apo në kryerje të detyrës</p> <p>1.Shërbimi Korrektues paguan shpenzimet e ceremonisë së varrimit për zyrtarin korrektues që vdes në detyrë, apo në kryerje të detyrës. Vendvarrimi do të caktohet nga anëtarët e familjes së zyrtarit korrektues. Shërbimi Korrektues do t'i paguajë shpenzimet në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.Transportin për bartjen e kufomës;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.Shpenzimet e udhëtimit për dy (2) persona shoqërues;</p>	<p style="text-align: center;">Article 212</p> <p style="text-align: center;">Compensation for death on duty or while performing the duty</p> <p>1.Correctional Service shall cover the funeral expenses for the correction officer who passed away on duty or while performing the duties. The location of the burial shall be determined by the members of the family of the correction officer. Correctional Service shall cover the following expenses:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.transport of the corpse;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.travel expenses for two (2) accompanying persons;</p>	<p style="text-align: center;">Član 212</p> <p style="text-align: center;">Nadoknada za smrt na dužnosti ili u obavljanju dužnosti</p> <p>1.Kazneno popravna služba plaća troškove pogreba za korektivnog službenika koji umre na poslu, ili u obavljanju dužnosti. Mesto gde će biti sahranjen određuje se od strane članova porodice korektivnog službenika. Kazneno popravna služba će pokriti troškove pogreba kao što sledi:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.transport za prevoz leša;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.putne troškove za dve (2) osobe koji su pratioci;</p>

<p>1.3.Shpenzimet e funeralit që nuk janë paguar në forma të tjera;</p> <p>1.4.Shpenzimet e tjera me aprovimin e ministrit.</p> <p>2.Shërbimi Korrektues do të paguaj bashkëshortin apo fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të zyrtarit korrektues, i cili vdes në detyrë apo në kryerje të detyrës me një ndihmë financiare të menjëhershme në një shumë që është e barabartë me pagën mujore bruto të shumëzuar me gjashtë (6). Një pagesë e tillë do të bëhet vetëm pasi të përcaktohet se bashkëshorti apo fëmijët kanë qenë të përkrahur nga zyrtari korrektues para vdekjes së tij ose saj. Në raste të caktuara sipas vlerësimit, Qeveria mund të ndaj shumë më të lartë financiare të menjëhershme për zyrtarin korrektues, i cili ka vdekur në kryerje të detyrës.</p> <p>3.Bashkëshorti i/e cili/a përcaktohet që ka qenë e përkrahur nga zyrtari korrektues dhe fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të zyrtarit korrektues i cili vdes në kryerje të detyrës kanë të drejtë në pension familjar, por vetëm deri në vlerën gjashtëdhjetë përqind (60%), të pagës bruto.</p>	<p>1.3.funeral expenses that were not covered in other forms;</p> <p>1.4.other expenses upon the approval of minister.</p> <p>2. Correctional Service shall provide the spouse or children under the age of eighteen (18) of the correction officer who passed away while on duty or during the performance of duties with an immediate financial assistance in an amount equal to six (6) months' gross salaries. Such an assistance will be provided only when ascertaining that the spouse or children were dependent on the correction officer prior to his death. At certain cases, following an assessment, the Government may allocate a higher financial sum for the correction officer who passed away during the performance of duties.</p> <p>3. The dependent spouse and children under the age of eighteen (18) of the correction officer who passed away during the performance of duties, shall be entitled to a family pension in the amount of sixty percent (60%) of the officer's gross salary.</p>	<p>1.3.pogrebne troškove koje nisu plaćene u drugim oblicima;</p> <p>1.4.ostale troškove uz sglasnost ministra.</p> <p>2.Kazneno popravna služba plaća suprūznika, ili decu korektivnog službenika ispod osamnest (18) godina, koji umre na poslu, ili tokom obavljanja dužnosti, finansijskom pomoći koja se isplaćuje odmah u iznosu koji je jednak sa mesečnom bruto platom pomnoženo sa šest (6). Takva isplata će se izvršiti samo kada se odredi da suprūznik, ili deca, su bili podržani od strane korektivnog službenika pre njegove, ili njene smrti. U određenim procenjenim slučajevima, Vlada može odvojiti veću finansijsku sumu za korektivnog službenika koji je preminuo tokom obavljanja dužnosti, koja se isplaćuje odmah.</p> <p>3.Suprūznik koji/a se odredi da je bio podržan od strane korektivnog službenika, i dece korektivnog službenika koji je preminuo u obavljanju dužnosti ispod osamnest (18) godina, imaju pravo na porodičnu penziju, ali samo u vrednosti do šezdeset (60%) od bruto plate.</p>
---	--	--

<p>4.Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Qeveria nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e kompensimeve për rastet e zyrtarëve korrektues, të cilët vdesin në detyrë, apo në kryerje të detyrës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 213 Procedura dhe masat disiplinore ndaj nëpunësve civil</p> <p>Procedura disiplinore, komisioni disiplinor dhe i ankesave, si dhe masat disiplinore ndaj nëpunësve civil, zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi për shërbimin civil.</p> <p style="text-align: center;">Neni 214 Procedura disiplinore ndaj zyrtarëve korrektues</p> <p>1.Procedurën disiplinore ndaj zyrtarëve korrektuese udhëheq komisioni disiplinor të cilin e emëron drejtori i institucionit korrektues. Për përgjegjësinë disiplinore vendosë drejtori i institucionit korrektues, me propozimin e komisionit disiplinor.</p> <p>2.Procedurën disiplinore kundër drejtorit të institucionit korrektues e udhëheqë</p>	<p>4. With the proposal of the Ministry of Justice, the Government shall adopt a bylaw setting out compensations for correction officers who passed away while on duty or during the performance of duties.</p> <p style="text-align: center;">Article 213 Procedure and disciplinary measures against civil servants</p> <p>For disciplinary procedure, disciplinary and appeal committee and disciplinary measures against civil servants, the respective provisions of the applicable legislation on civil service shall apply.</p> <p style="text-align: center;">Article 214 Disciplinary procedure against correction officers</p> <p>1. Disciplinary procedure against correction officers shall be managed by the disciplinary committee which is appointed by the Director of correctional institution. The disciplinary responsibility shall be decided upon by the Director of correctional institution, upon the proposal of the disciplinary committee.</p> <p>2.The disciplinary procedure against the director of the correctional institution shall be</p>	<p>4.Na predlog Ministra Pravde, Vlada donosi podzakonski akt za određivanje nadoknade za slučajeve korektivnih službenika koji umru na posao, ili u obaljanju dužnosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 213 Procedure i disciplinske mere protiv državnih službenika</p> <p>Disciplinske procedure, disciplinska komisija i komisija za žalbe, kao i disciplinske mere protiv državnih službenika, sprovode se odgovarajuće odredbe pravosnažnog zakonodavstva za civilne službenike.</p> <p style="text-align: center;">Član 214 Disciplinski postupci protiv korektivnih službenika</p> <p>1.Disciplinski postupci protiv korektivnih službenika vodi disciplinska komisija koju imenuje direktor Kazneno popravne ustanove. O disciplinskoj odgovornosti odlučuje direktor Kazneno popravne ustanove, na predlog disciplinske komisije.</p> <p>2.Disciplinski postupak protiv direktora Kazneno popravne ustanove vodi</p>
--	--	--

<p>Komisioni Disiplinor, të cilin e emëron Drejtori i Përgjithshëm. Për përgjegjësinë disiplinore vendosë Drejtori i Përgjithshëm me propozimin e Komisionit Disiplinor.</p> <p>3.Kundër vendimit të shkallës së parë të nxjerrë në procedurën disiplinore mund të parashtrohet ankesë në komisionin për ankesa, në afat prej tete (8) ditësh nga data e pranimi të vendimit.</p> <p>4.Vendimi i Komisionit për Ankesa përjashtimisht rasteve të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, është përfundimtar.</p> <p>5.Shkeljet, masat dhe procedura disiplinore për zyrtarët korrektues, si dhe përbërja e komisionit për ankesa rregullohen me akt nënligjor, të cilin e nxjerr Ministri.</p>	<p>managed by the disciplinary committee appointed by the General Director. The disciplinary responsibility shall be decided upon by the Director of correctional institution, upon the proposal of the disciplinary committee.</p> <p>3. The decision of first instance rendered in the disciplinary procedure may be appealed to the appeal committee, within eight (8) days from the receipt of the decision.</p> <p>4.The decision of appeal committee is final, with the exception of cases of termination of employment.</p> <p>5.Violations, measures and disciplinary procedure against the correction officers and the composition of appeal committee shall be governed by a bylaw adopted by the Minister.</p>	<p>disciplinska komisija koju imenuje Generalni Direktor. O disciplinskoj odgovornosti odlučuje Generalni Direktor, na predlog disciplinske Komisije.</p> <p>3.Protiv prvostepene odluke koja je donešena u disciplinskom postupku, može se podneti žalba u komisiju za žalbe, u roku od osam (8) dana od datuma prijema odluke.</p> <p>4.Odluka Komisije za žalbe sa izuzetkom slučajeva prekida radnog odnosa, je konačna.</p> <p>5.Kršenja, mere i disciplinski postupci za kazneno popravne službenike kao i sastav komisije za žalbe uređuju se podzakonskim aktom koji donosi Ministar.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 215 Masat disiplinore</p> <p>1.Për zyrtarët korrektues mund të shqiptoj masat disiplinore, si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.Vërejtje me gojë;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.Vërejtje me shkrim;</p>	<p style="text-align: center;">Article 215 Disciplinary measures</p> <p>1.Against the correction officers the following disciplinary measures can be imposed:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.verbal warning;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.written warning;</p>	<p style="text-align: center;">Član 215 Disciplinske mere</p> <p>1.Korektivnim službenicima mogu se izreći sledeće disciplinske mere:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.usmena opomena;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.pismena opomena;</p>

<p>1.3.Zvogëlimi i së ardhurave personale deri në tridhjetë përqind (30%), duke pasur parasysh natyrën e shkeljes;</p> <p>1.4.Transferim në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj;</p> <p>1.5.Ulja në pozitë;</p> <p>1.6.Suspendimi;</p> <p>1.7.Ndërprerjen e marrëdhënies së punës.</p> <p>2.Për masat e përcaktuara nga paragrafi 1.1 deri 1.5 të paragrafit 1 të këtij neni, pas zhvillimit të procedurave përkatëse propozon Komisioni dhe vendos drejtori i institucionit korrektues. Për masën e përcaktuar në paragrafin 1.7 të paragrafit 1 të këtij neni, vendosë Drejtori i Përgjithshëm.</p> <p>3.Përjashtimisht nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, për masën e suspendimit vendosë Drejtori i Institucionit Korrektues për zyrtarët korrektues, kur kjo vlerësohet e nevojshme.</p> <p>4.Masa disiplinore nga paragrafi 1 i këtij neni shqiptohen në harmoni me shkallën e</p>	<p>1.3.deduction of personal income up to thirty per cent (30%), considering the nature of violation;</p> <p>1.4.transfer to another correctional institution up to six (6) months;</p> <p>1.5.demotion;</p> <p>1.6.suspension;</p> <p>1.7.termination of employment.</p> <p>2.For measures specified in paragraph 1.1 through 1.5 of this article, after following the respective procedures, the Committee shall propose and the Director of correctional institution shall decide. For the measure specified in paragraph 1.7 of this article, the General Director shall decide.</p> <p>3.Exceptionally from paragraph 1 and 2 of this article, the measure of suspension shall be decided upon by the Director of the correctional institution for the correction officers, whenever that is deemed necessary.</p> <p>4.The disciplinary measure from paragraph 1 of this article shall be imposed in proportion</p>	<p>1.3.smanjenje ličnih primanja do trideset (30%), imajući u vidu vrstu prekršaja;</p> <p>1.4.transfer u drugoj Kazneno popravnu ustanovu do šest (6) meseci;</p> <p>1.5.smanjenje radnog položaja;</p> <p>1.6.suspenzija;</p> <p>1.7.prekid radnog odnosa.</p> <p>2.Za mere određene iz stava 1.1 do 1.5 stava 1 ovog člana, nakon razvoja određenih postupaka predlaže Komisiji i odlučuje direktor Kazneno popravne ustanove. Za mere određene iz stava 1.7 stava 1 ovog člana, odlučuje Generalni Direktor.</p> <p>3.Izuzetak iz stava 1 i 2 ovog člana, o meri suspenzije odlučuje Direktor Kazneno popravne ustanove za kazneno popravne službenike, kada se ovo proceni da je potrebno.</p> <p>4.Disciplinska mera iz stava 1 ovog člana izriče se u saglasnosti sa stepenom</p>
---	---	--

<p>përgjegjësishë disiplinore dhe pasojat e shkeljes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 216 Publiciteti i punës së Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues</p> <p>1.Puna e Shërbimit Korrektues dhe e Shërbimit Sprovues është publike.</p> <p>2.Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues apo Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues, drejtpërdrejtë apo nëpërmjet personave të cilët i autorizojnë, e informojnë opinionin për ekzekutimin e sanksioneve, apo të punëve sprovuese me kusht që me atë të mos shkelet sekreti zyrtar, seriozisht të mos rrezikohet siguria apo mbajtja e rendit në institucionin korrektues në të cilën ekzekutohet sanksioni, apo kryhen punët sprovuese.</p> <p>3.Drejtorët e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues, me pëlqimin e Ministrit, caktojnë zëdhënësit.</p> <p>4.Të gjitha informacionet lidhur me personat e dënuar dhe të paraburgosurit janë</p>	<p>with the level of disciplinary responsibility and consequences of the violation.</p> <p style="text-align: center;">Article 216 Publicity of work of the Correctional Service and Probation Service</p> <p>1.The work of Correctional Service and Probation Service is public.</p> <p>2.The Minister and the General Director of the Correctional Service, or the General Director of the Probation Service, directly or through their authorized representatives, shall inform the public about the execution of sanctions or probation works, provided that such undertaking will not violate the official secret, will not seriously endanger the security or the order in the correctional institution where the sanction is being executed or probation works are being performed.</p> <p>3.The General Directors of the Correctional Service and Probation Service, with the consent of the Minister, shall appoint the spokesperson.</p> <p>4.All information related to the convicted persons and detainees are confidential and</p>	<p>disciplinske odgovornosti i posledice prekršaja.</p> <p style="text-align: center;">Član 216 Publicitet Kazneno popravne službe i Probacione Službe</p> <p>1.Rad Kazneno popravne službe i Probacione službe su javni.</p> <p>2. Ministar i Generalni Direktor Kazneno popravne službe ili Generalni Direktor Probacione Službe, neposredno ili preko lica koja ga ovlašćuju, obaveštavaju javnost o izvršenju sankcija ili probnih radova, pod uslovom da ne krše službenu tajnost, da ozbiljno ne ugrozi sigurnost, ili da zadrži red u Kazneno popravnu ustanovu u kojoj se izvršava sankcija, ili da se obavlja probni rad.</p> <p>3. Generalni Direktori Kazneno popravne službe i Probacione Službe, uz saglasnost ministra, imenuju glasno-govornika.</p> <p>4. Sve informacije u vezi sa osuđenim licima i pritvorenicima su poverljive, ne otkrivaju se ili su skrivene od javnosti ili medija.</p>
--	---	---

<p>konfidenciale, nuk zbulohen dhe nuk bëhen të njohura për opinionin apo për mediat.</p> <p>5.Përrjashtimisht nga paragrafi 4 i këtij neni, Ministria e Drejtësisë mund t'i bëjë të njohura informacionet konfidenciale për mediat ose grupet tjera të informimit publik, nëse dhënia e këtyre informacioneve është në pajtim me interesin e përgjithshëm shoqëror. Informacionet e tilla konfidenciale nuk zbulohen, nëse zbulimi i tyre paraqet rrezik për rendin dhe sigurinë e përgjithshme të institucioneve korrektuese, apo nëse dhënia e këtyre informacioneve mund të dëmtojë qëllimin e dënimit.</p> <p>6.Personat e dënuar nuk intervistohen nga mediat, grupet publike lokale apo personat tjerë pa pëlqim paraprak të tij, si dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues.</p> <p>7.Ministri nxjerr akt nënligjorë mbi fshehtësinë e informacioneve, dhënien dhe zbulimin e tyre, si dhe udhëzime për mediat.</p> <p>8.Dispozitat e këtij neni nuk e cenojnë autorizimin që e kanë Avokati i Popullit, gjykatësit dhe zyrtarët tjerë të drejtësisë në bazë të ligjit në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare dhe Ligjin për Mbrojtjen e të</p>	<p>shall not be disclosed or made known to the public or media.</p> <p>5.Exceptionally from paragraph 4 of this article, the Ministry of Justice may disclose confidential information to the media or other groups of public information if the provision of such information is in the general social interest. Such confidential information shall not be disclosed if such disclosure would pose risk to the general order and security of the correctional institutions, or if the provision of such information could affect the purpose of the punishment.</p> <p>6.The convicted persons shall not be interviewed by the media, local public groups or other persons, without prior consent of the General Director of the Correctional Service.</p> <p>7.The Minister shall adopt a bylaw on the confidentiality, provision and disclosure of information as well as the guidelines for the media.</p> <p>8.The provisions of this article shall not violate the authorization of the Ombudsperson, judge and other officers of justice based on the applicable law on access to official documents and Law on the</p>	<p>5. Izuzetak iz stava 4. ovog člana, Ministarstvo Pravde može otkriti poverljive informacije medijima ili drugim javnim informativnim grupama ako je otkrivanje takvih informacija u skladu sa opštim društvenim interesom. Takve poverljive informacije se ne objavljuju ako njihovo obelodanjivanje predstavlja rizik za red i opšte obezbeđenje Kazneno popravni ustanovima, ili ukoliko otkrivanje takvih informacija može oštetiti svrhu kažnjavanja.</p> <p>6. Osuđene osobe ne intervjuišu se od strane medija, lokalne javne grupe ili druga lica bez njihove prethodne saglasnosti i generalnog Direktor Kazneno popravne službe.</p> <p>7.Ministar izdaje podzakonske akte o poverljivosti informacija, njihovim davanjem i obelodanjivanjem, kao i upustvima za medije.</p> <p>8. Odredbe ovog člana neće uticati na nadležnost Advokata Građana, sudija i drugih službenika pravde prema važećem zakonu o pristupu službenim dokumentima i Zakonu o zaštiti podataka o ličnosti i Krivičnom Zakonu Kosova.</p>
--	---	--

<p>Dhënave Personale dhe Kodit Penal të Kosovës.</p> <p>9.Ministri mund t'i lejoj qasje në dokumente organizatave të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në pajtim me aktin për rendin shtëpiak të institucioneve korrektuese.</p> <p style="text-align: center;">Neni 217 Vizitat e personave apo grupeve në institucionet korrektuese</p> <p>1. Drejtori i Përgjithshëm është i autorizuar për miratimin e vizitave nga ana e personave apo grupeve në institucionet korrektuese.</p> <p>2.Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk vlejné për përfaqësuesit e organeve shtetërore, kur kryejné punët nga kompetenca e tyre.</p> <p>3.Në veçanti, duhet pas kujdes që të mundësohet vizita e përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe të huaj, si dhe të shoqatave të cilat merren me mbrojtjen e drejtave njerëzore, të punëtorëve shkencor, të cilët merren me hulumtimin e kriminalitetit, si dhe të studentëve të fakulteteve përkatëse.</p>	<p>protection of personal data and the Criminal Code of Kosovo.</p> <p>9.The Minister may grant access to documents to the organizations that deal with the protection of human rights in accordance with the house order of the correctional institutions.</p> <p style="text-align: center;">Article 217 Visits of persons or groups in correctional institutions</p> <p>1. The General Director has the authority to approve visits by individuals or groups to correctional institutions.</p> <p>2. Provisions from paragraph 1 of this article shall not be valid for representatives of state bodies when performing duties within their area of competencies.</p> <p>3. Special attention shall be paid to enabling visits of local and international institutions and associations' representatives dealing with the protection of human rights, scientific researchers dealing with crime research, representatives of the media and students of the respective faculties.</p>	<p>9. Ministar može dozvoliti pristup dokumentima organizacijama koje se bave zaštitom ljudskih prava u skladu sa aktom o unutrašnjem poretku Kazneno popravnih ustanovima.</p> <p style="text-align: center;">Član 217 Posete osoba ili grupa u Kazneno popravnim ustanovima</p> <p>1. Generalni Direktor je ovlašćen da odobrava posete lica ili grupa u Kazneno popravnim ustanovima.</p> <p>2. Odredbe stava 1 ovog člana ne primenjuju se na predstavnike državnih organa prilikom vršenja poslova iz njihove nadležnosti.</p> <p>3. Naročito treba voditi brigu kako bi se omogućile posete predstavnika lokalnih i stranih institucija, kao i udruženja koja se bave zaštitom ljudskih prava, naučnim radnicima koji su kroz istraživanje o kriminalu i studentim relevantnih fakulteta.</p>
---	---	---

<p>4. Personave të cilët vizitojnë institucionin korrektues, Drejtori i Përgjithshëm mund të lejoj bisedë me personat e dënuar apo me personat e caktuar të dënuar, me prezencën, apo pa prezencën e personit zyrtar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 218 Medaljet, lëvdatat, shpërblimet dhe mirënjohjet</p> <p>1. Kryeministri, Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm janë të autorizuar t'u japin medalje, lëvdata, shpërblime dhe mirënjohje, zyrtarëve korrektues, punëtorëve të tjerë të Shërbimit Korrektues, personave fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj që e kanë dalluar vetën me meritat e tyre.</p> <p>2. Kryeministri jep medaljen, si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. Medaljen e nderit.</p> <p>3. Ministri jep medaljet, si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. Medaljen për merita;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.2. Medaljen për trimëri; dhe</p> <p style="padding-left: 40px;">3.3. Medaljen e shpëtimit të jetës.</p>	<p>4. The General Director may approve conversations with convicted persons, with or without the presence of the official person, for persons visiting correctional institutions.</p> <p style="text-align: center;">Article 218 Medals, commandments, rewards and recognitions</p> <p>1. Prime Minister, Minister and General Director are authorized to give medals, appreciations, rewards and acknowledgements to correctional officers, other employees of the Correctional Service, distinct national and international legal and natural persons on the basis of merits.</p> <p>2. The Prime Minister shall award the following medal:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. Medal of Honor;</p> <p>3. The Minister shall award the following medals:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. Medal of Merit;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.2. Medal of Courage; and</p> <p style="padding-left: 40px;">3.3. Medal on Life Saving.</p>	<p>4. Lica koja posećuju Kazneno popravnu ustanovu, generalni Direktor može dozvoliti razgovore sa osuđenim licima ili sa određenim osuđenim licima sa prisustvom ili odsustvom službenog lica.</p> <p style="text-align: center;">Član 218 Medalje, pohvale, nagrade i priznanja</p> <p>1. Premijer, Ministar i generalni Direktor su ovlašćeni da daju medalje, pohvale, nagrade i zahvalnost korektivnim službenicima, drugim službenicima Kazneno popravne službe, fizičkim i pravnim licama u zemlji i strancima koji su se istakli sa svojim zaslugama .</p> <p>2. Premijer daje sledeću medalju:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. medalja časti.</p> <p>3. Ministar daje sledeće medalje:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. medalja za zasluge;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.2. medalja za hrabrost; i</p> <p style="padding-left: 40px;">3.3. medalja za spašavanje života.</p>
---	--	--

<p>4.Drejtori i Përgjithshëm jep medaljet, si në vijim:</p> <p>4.1.Medaljen për shërbim të dalluar;</p> <p>4.2.Medaljen korrektuese për lëvdim; dhe</p> <p>4.3.Medaljen për shërbim të besnikërisë.</p> <p>5.Dispozitat e këtij neni përshtatshëmrisht zbatohen edhe për zyrtarët sprovues.</p>	<p>4. General Director shall award the following medals:</p> <p>4.1. Medal on Distinctive Service;</p> <p>4.2. Correctional Medal of Appreciation; and</p> <p>4.3. Medal on Loyal Service.</p> <p>5.The provisions of this article shall accordingly apply also to the probation officers.</p>	<p>4. Generalni direktor izdaje sledeće medalje:</p> <p>4.1. medalja za istaknutu uslugu;</p> <p>4.2. korekcionu medalju za pohvale; i</p> <p>4.3. medalja za uslugu lojalnosti.</p> <p>5. Odredbe ovog člana prilagodljivo se primenjuju i za probacione službenike.</p>
<p style="text-align:center">KREU XXII SHËRBIMI SPROVUES</p> <p style="text-align:center">Neni 219 Veprimtaria e Shërbimit Sprovues</p>	<p style="text-align:center">CHAPTER XXII PROBATION SERVICE</p> <p style="text-align:center">Article 219 Activity of Probation Service</p>	<p style="text-align:center">POGLAVLJE XXII PROBACIONA SLUŽBA</p> <p style="text-align:center">Član 219 Aktivnosti probacione službe</p>
<p>1.Shërbimi Sprovues është organ qendror i administratës shtetërore në vartësi të Ministrisë.</p> <p>2.Shërbimi Sprovues është përgjegjës për kryerjen e punëve lidhur me:</p> <p>2.1.Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të riintegritimit shoqëror</p>	<p>1.Probation Service is central body of the state administration within the Ministry.</p> <p>2.Probation Service is responsible for performing works related to:</p> <p>2.1.organizing, applying and supervising the execution of the alternative punishments and the social</p>	<p>1. Probaciona služba je centralni organ državne uprave podređen Ministarstvu.</p> <p>2. Probaciona Služba je odgovorna za izvođenje radova koji se odnose na:</p> <p>2.1. Organizovanje, sprovođenje i nadgledanje izvršenja alternativnih</p>

<p>të personave të dënuar (punët sprovuese);</p> <p>2.2.Përgatitjen e anketës sociale dhe raportet para ndëshkuese për kryerësit e veprave penale;</p> <p>2.3.Vlerësimin e rrezikut kriminogjen dhe për caktimin e nevojave për trajtim të kryesve të veprave penale;</p> <p>2.4.Ekzekutimin e masave të diversitetit dhe masave edukative për të mitur;</p> <p>2.5.Mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimeve alternative;</p> <p>2.6.Mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj kryerësve të varur nga droga, ose alkooli të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm rehabilitues i cili mbahet në liri;</p> <p>2.7.Mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj personave të dënuar të liruar me kusht;</p> <p>2.8.Zhvillimi i programeve individuale të mbikëqyrjes;</p> <p>2.9.Hartimin e raporteve për ekzekutimin e dënimeve alternative dhe personave të liruar me kusht nga burgu</p>	<p>re-integration of the convicted persons (probation duties);</p> <p>2.2. preparing social inquiries and pre-punishment reports for the committals of criminal acts;</p> <p>2.3. evaluating criminal risk and assessing the treatment needs of the committers of criminal acts;</p> <p>2.4. executing diversity measures and educational measures for juvenile;</p> <p>2.5.supervising and assisting convicted persons serving alternative punishments;</p> <p>2.6.supervising and assisting perpetrators addicted to drugs or alcohol subject to mandatory rehabilitation treatment which is executed in liberty;</p> <p>2.7. supervising and supporting the convicted persons on parole;</p> <p>2.8.developing of individual supervising programs;</p> <p>2.9. drafting of reports on execution the alternative punishments and on</p>	<p>kazni i shoqërore re-integracione osuđenih lica (probni rad);</p> <p>2.2. Priprema društvenog istraživanja i predkazničkih izveštaja za počinioce;</p> <p>2.3. Procena krivičnog rizika i utvrđivanje potreba za postupanjem prema počiniocima krivičnih dela;</p> <p>2.4. Izvršavanje mera raznovrsnosti i obrazovnih mera za maloletnike;</p> <p>2.5. Nadzor i pomoć osuđenim licima tokom izdržavanje alternativnih kazni;</p> <p>2.6. Razmatra i pomaže licima zavisne od droge ili alkohola, koji podležu obaveznom rehabilitacionom tretmanu koji se drži na slobodi;</p> <p>2.7. Nadzor i pomoć osuđenim licima na uslovnoj slobodi;</p> <p>2.8. Razvoj pojedinačnih nadzornih programa;</p> <p>2.9.Sastav izveštaja o izvršenju alternativnih kazni i licima uslovno oslobođenim iz zatvora za Tužioca,</p>
--	---	--

<p>për prokuroritë, gjykatat dhe Panelin për Lirim me Kusht;</p> <p>2.10.Udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre;</p> <p>2.11.Mbajtjen e evidencave dhe regjistrave për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative në sistemin elektronik për menaxhimin e të dhënave;</p> <p>2.12.Me qëllim të eliminimit të shkaqeve të korrupsionit në Shërbimin Sprovues dhe institucionet në vartësi të tij, në pajtim me këtë Ligj, aktet nënligjore përkatëse, të cilat do të nxjerrën për zbatimin e këtij ligji, duhet të vendosin dispozitat antikorruptive, në veçanti për promovimin dhe ekzistimin e sistemit të qartë për shpërblime dhe sanksione në pjesën e zbatimit të programit të veprimit;</p> <p>2.13.Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.</p> <p>3.Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Sprovues në zbatimin e punëve sprovuese bashkëpunon me organet e pushtetit shtetëror, me institucionet shkencore dhe</p>	<p>parole by jail for the prosecutors, courts and Parole Panel;</p> <p>2.10.guiding and supporting convicted persons on the completion of their sentence;</p> <p>2.11. keeping evidence and registry of the execution of alternative measures and punishments in electronic system for data management;</p> <p>2.12..In order to eliminate the causes of corruption in the Probation Service and institution within it, in accordance with the Law, respective bylaws to be adopted for the implementation of this law shall incorporate anti-corruption provisions, in particular the promotion and existence of clear system for rewards and sanctions in the section covering the action program implementation;</p> <p>2.13.performing other works provided by law.</p> <p>3.The Ministry of Justice and Probation Service shall cooperate with state bodies, scientific and other institutions, local government bodies and other institutions and</p>	<p>Sudove i veçem za uslovno oslobađanje;</p> <p>2.10. Uputstvo i podržavanje osuđenih lica na kraju kazne;</p> <p>2.11.Vođenje evidencija i registrovanja za izvršenje alternativnih mera i kazni u sistemu elektronskog upravljanja podacima;</p> <p>2.12. U cilju otklanjanja osnovnih uzroka korupcije u Probacionoj Službi i njegovim podređenim institucijama, u skladu sa ovim zakonom, relevantni podzakonski akti koji će biti izdati za sprovođenje ovog zakona trebaju uspostaviti antikorupcijske odredbe posebno za promociju i postojanje jasnog sistema nagrađivanja i sankcija u delu implementacije akcionog programa;</p> <p>2.13. Takođe vrši i druge poslove propisane zakonom.</p> <p>3. Ministarstvo Pravde i Probaciona Služba u sprovođenju probnog rada saraduju sa državnim organima, sa naučnim institucijama i drugim institucijama, sa</p>
--	---	---

<p>institucionet e tjera, me organet e pushtetit lokal dhe institucionet e tjera, personat juridik dhe shkëmben informata relevante.</p> <p>4.Shërbimi Sprovues ka statusin e personit juridik dhe ka selinë në Prishtinë.</p> <p>5.Shërbimi Sprovues ka logon, stemën dhe vulën.</p> <p>6.Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Shërbimit Sprovues rregullohet me akt të veçantë, të cilin e miraton Ministri.</p>	<p>legal persons as well as share relevant information for the purpose of implementing probation duties.</p> <p>4.Probation Service has the status of legal entity and has its seat in Prishtina.</p> <p>5.Probation Service has its logo, emblem and stamp.</p> <p>6.The internal organization and systematization of the Probation Service shall be governed by a separate act adopted by the Minister.</p>	<p>organima lokalne samouprave i drugim institucijama, pravnim licima i razmenjuju relevantne informacije.</p> <p>4. Probaciona Služba ima status pravnog lica sa sedištem u Prištini.</p> <p>5. Probaciona Služba ima logotip, amblem i pečat.</p> <p>6. Unutrašnja organizacija i sistematizacija Probacione Službe regulisana je posebnim aktom odobren od strane Ministra.</p>
<p>Neni 220 Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues</p>	<p>Article 220 General Director of Probation Service</p>	<p>Član 220 Generalni Direktor Probacione Službe</p>
<p>1.Shërbimin Sprovues e udhëheq Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues.</p> <p>2.Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues emërohet me konkurs të shpallur nga Ministria e Administratës Publike me propozim të Ministrisë të Drejtësisë në pajtim me dispozitat për Shërbimin Civil për emërimin për pozitën e nivelit të lartë drejtues në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Komisioni profesional vlerësues duhet të përbëhet nga profesionist përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësues nga shoqëria civile, gjyqtar,</p>	<p>1.The Probation Service shall be managed by the General Director of the Probation Service.</p> <p>2.The General Director of Probation Service is appointed through a vacancy announced by the Ministry of Public Administration upon the proposal of the Minister of Justice, in accordance with the provisions on Civil Service for the appointment of the senior management positions in the Civil Service of the Republic of Kosovo. The professional evaluation committee shall consist of professional representatives of the Ministry of Justice, representatives of civil society, Judge,</p>	<p>1.Probacionu Službu vodi generalni Direktor Probacione Službe.</p> <p>2. Generalni Direktor Probacione Službe imenuje se sa objavom konkursa od strane Ministarstva za Državnu Upavu na predlog Ministra Pravde u skladu sa odredbama Državne Službe za imenovanje viših rukovodećih položaja u Državnoj Službi Republike Kosovo. Odbor za profesionalnu procenu treba da se sastoji od profesionalnih predstavnika Ministarstva Pravde, predstavnika civilnog društva, Sudija,</p>

<p>Prokurori i Shtetit dhe Fakultetit të Drejtësisë, drejtimi penalo-juridik.</p> <p>3.Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues emërohet për periudhë kohore pesë (5) vjeçare e me mundësi rizgjedhje.</p> <p>4.Për punën e tij Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues i përgjigjet drejtpërdrejtë Ministrit.</p> <p>5.Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues udhëheqë, drejton dhe kontrollon Shërbimin Sprovues dhe të gjitha çështjet lidhur me Shërbimin Sprovues.</p> <p>6.Shërbimi Sprovues mund të ketë edhe zëvendës drejtor, i cili emërohet në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi për emërimin në pozitat e nivelit drejtues. Zëvendës drejtori për punën e tij i përgjigjet Drejtorit të Përgjithshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 221 Kushtet për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues</p> <p>1.Detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues mund ta ushtroj kandidati, i cili i plotëson kushtet në vijim:</p>	<p>State prosecutor and Faculty of Law, branch of criminal law.</p> <p>3.The General Director of Probation Service is appointed for a period of five (5) years with the possibility of reappointment.</p> <p>4.The General Director of the Probation Service shall report directly to the Minister.</p> <p>5.The General Director of the Probation Service shall manage, run and monitor the Probation Service and all matters related to the Probation Service.</p> <p>6.Probation Service may have a deputy director, who will be appointed in accordance with the respective provisions of the applicable legislation on the appointment of management positions. The deputy director shall report to the General Director.</p> <p style="text-align: center;">Article 221 Requirements for the appointment of the General Director of Probation Service</p> <p>1.The duty of General Director of the Probation Service may be exercised by the applicant who meets the following requirements:</p>	<p>Državnih Tužilaca i Pravosudnog Fakulteta, krivičnog pravosuđa.</p> <p>3.Generalni Direktor Probacione Službe imenuje se na period od pet (5) godina sa mogućnošću ponovnog izbora.</p> <p>4. Generalni direktor Probacione Službe direktno odgovara Ministru za njegov rad.</p> <p>5. Generalni Direktor Probacione Službe vodi, usmerava i kontroliše Probacionu Službu i sva pitanja koja se odnose za Probacionu Službu.</p> <p>6. Probaciona Služba može takođe imati zamenika direktora, koji se imenuje u skladu sa relevantnim odredbama zakonodavstva koji je na snazi za imenovanje na položaj rukovodstva. Zamenik direktora odgovara generalnom Direktor za njegov rad.</p> <p style="text-align: center;">Član 221 Uslovi za imenovanje Generalnog Direktora Probacione Službe</p> <p>1. Dužnost generalnog Direktora Probacione Službe može vršiti kandidat koji ispunjava sledeće uslove:</p>
--	--	---

<p>1.1.Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2.Të ketë përgatitje universitare;</p> <p>1.3.Të ketë tetë (8) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë pune në vende udhëheqëse;</p> <p>1.4.Të mos jetë anëtarë i ndonjë partie politike;</p> <p>1.5.Të ketë reputacion moral dhe profesional, dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale.</p>	<p>1.1.is a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2.has a university degree;</p> <p>1.3.has eight (8) years of professional experience, of which at least five (5) years of managerial experience;</p> <p>1.4.is not a member of any body of a political party;</p> <p>1.5.has moral and professional reputation and is not convicted of a criminal offence.</p>	<p>1.1.da bude građanin Republike Kosova;</p> <p>1.2. da ima fakultetsko obrazovanje;</p> <p>1.3. da ima osam (8) godina profesionalnog iskustva, od kojih najmanje pet (5) godina radnog iskustva na vodećim pozicijama;</p> <p>1.4. da ne bude član bilo kog organa političke stranke;</p> <p>1.5. da imaju moralnu i profesionalnu reputaciju, i da ne budu osuđivan za krivično delo.</p>
